

INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE

**Seria e kërkimeve politike
STUDIMI #2**

ISLAMI POLITIK NDËR SHQIPTARËT

A po vijnë talibanët në Ballkan?

Prishtinë, qershor 2005
Ribotim

KIPRED

The logo for KIPRED features the word "KIPRED" in a bold, blue, sans-serif font. A yellow, stylized graphic element, resembling a swoosh or a partial circle, is positioned behind the letters, starting from the bottom left and curving upwards and to the right.

ISLAMI POLITIK NDËR SHQIPTARËT

A po vijnë talibanët në Ballkan?

Prishtinë, qershor 2005
Ribotim

Këtë projekt e ka përkrahur Qendra Ndërkombëtare “Olof Palme”, Suedi dhe Rockefeller Brothers Fund, SHBA.

Mendimet e shprehura në këtë studim janë të autorit dhe jo domosdo të KIPRED-it.

Ky hulumtim është përpiluar nga: Isa Blumi

Përkthyer nga: Ilir Dugolli, L.L.M.

Lektor: Prof. ass. Dr. Nebi Caka

Copyright © KIPRED 2005. Botimi i parë 2003. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet ose të transmetohet, në asnjë mënyrë dhe me asnjë mjet, në mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjim, incizim ose ndonjë mënyrë tjetër, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit. Ju lutemi, kontaktoni në postën elektronike: info@kipredinstitute.org ose në tel. +381 38 555 887.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime Politike
“Kodra e Diellit”, Rruga 3, Lam. 39
Prishtinë, Kosova (UNMIK)
Telefoni&faksi: +381 38 555 887
www.kipredinstitute.org

Përmbajtja

Përmbledhja ekzekutive

Hyrje

Përkufizimi i islamit shqiptar

Projekti jugosllav dhe sufizmi në Kosovë, 1945-1999

Të kuptuarit e doktrinës vehabite

Identifikimi i krizës

Përpijekjet vendore për të adresuar forcën në rritje të SJCRKC-së

Shqipëria: Model për Kosovën?

Përfundimet

Sugjerime për zbrapsjen e trendeve të lartpërmendura

Shënime

Përmbledhja ekzekutive

Kosova shpeshherë është cilësuar si “mozaik kulturor”. Ndonëse cilësimi i tillë ende mbetet i saktë, ka forca të ndryshme të cilat janë kundër ruajtjes së kësaj trashëgimie. Ky punim hulumton gjasat që larmia fetare e Kosovës, tanimë e ngulfatur për vite të tëra, të jetë në rrezik të shtuar, madje edhe përkundër vendosjes këtu të bashkësisë ndërkombëtare në verë të vitit 1999. Me këtë rast sugjerohet se, si pasojë e neglizhencës ndaj bashkësisë kosovare shqiptare dhe stereotipave të ngurtë të shumë administratorëve ndërkombëtarë për besimin dhe besimtarët islamë, në Kosovë ekzistojnë gjasat nga kërcënim i rritje e sipër i radikalizimit.

Ironia tragjike e këtij raporti qëndron në faktin se ai tregon për neglizhencën e panevojshme të një pjese të bashkësisë ndërkombëtare. Kryesisht për shkak të dështimit të bashkësisë ndërkombëtare në vlerësimin e larmisë së trashëgimisë shpirtërore të shqiptarëve të Kosovës, politikat e kohës së Jugosllavisë për homogjenizim kulturor janë vazhduar nga një varg organizatash “humanitare”, të cilat që nga viti 1999 kanë hyrë në Kosovë.

Ky punim e përcjell historinë e kësaj dukurie duke u përqëndruar në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, kur përpjekjet e udhëhequra nga Beogradi për të dobësuar ndikimin e një vistre qendrash shpirtërore në Kosovë, kanë rezultuar në dobësi strukturore për islamin tradicional në rajon. Duke lidhur këto përpjekje të kaluara për homogjenizim të praktikave fetare në Kosovë me aktivitetet e financuara nga sauditët, e në veçanti të grupeve ndër pjesët fshatare të Kosovës, sugjerohet se lënia anash nga organizatat humanitare sekulare e bashkësive fshatare në Kosovë, shpien drejt uzurpimit të asaj që ka mbetur nga tradita tolerante islame në Kosovë. Në këtë punim argumentohet se duke e lënë përkujdesjen për arsim, strehim dhe ushqim të një pjese të madhe të popullsisë rurale në Kosovë në duar të organizatave të cilat nxisin mësim të ngurta dhe jotolerante të vehabizmit islamik, UNMIK-u dhe OSBE-ja mund të kërcënojnë të ardhmen e stabilitetit në rajon.

Në fund, si rezultat i kësaj neglizhence del se bashkësia ndërkombëtare është duke lejuar krijimin e enklavave sociale dhe kulturore, gjë që do të mund të përsëriste shumë nga ajo që tanimë kemi parë ndër refugjatët afganë në Pakistan gjatë viteve 1980 (lexo: “talibanizimi i popullatës shqiptare muslimane në Kosovë”).

Hyrje

“Shqiptarët janë mulsimanë për më shumë se 500 vjet dhe nuk kanë nevojë që të huajt [arabët] t’u tregojnë se cila është mënyra e drejtë e besimit islam.”

Rexhep Boja, Myftiu i Kosovës¹

Citati i mësipërm tregon se si zyrtari më i lartë musliman sunit në Kosovë, Rexhep Boja, e sheh praninë e “organizatave joqeveritare” (OJQ) në Kosovë. Përkundër të qenurit shfrytëzues të qindra mijëra dollarëve në formë ndihmash, shumica prej të cilave ka shkuar në rindërtim të objekteve të shkatërruara të Bashkësisë Islame në Kosovë, e cila udhëhiqet nga z. Boja, myftiu i Kosovës dëshiron që t’i ketë jashtë “arabët”. Mosbesimi i tillë publik, madje zemërimi ndaj praktikave salafi (puriste) të shumicës së qytetarëve të Arabisë Saudite të cilët punojnë në Kosovë, vjen nga personi i cili ka fituar titullin e magjistratit dhe të doktorit në universitete të Arabisë Saudite. Vlerësimi i asaj që është duke ndodhur mund të ndihmojë në adresimin e disa prej kërcënimeve afatgjata të stabilitetit rajonal dhe për të vënë në pah më mirë gabimet thelbësore të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë gjatë tre-katër viteve të fundit.

Ky punim vë në pah burimet e tensioneve të tilla, të cilat kanë origjinën jo vetëm në parimet doktrinare në të cilat thirren si muslimanët vendorë, ashtu edhe sauditët ultra-ortodoksë dhe OJQ-të e Gjirit Arab, por edhe në mënyrën e diskutueshme sesi fuqitë perëndimore kanë caktuar prioritetet e tyre në rajon. Qasja e ngushtë ndaj trashëgimisë islamike të Kosovës ka lënë një faqe shpirtërore esenciale në jetën e personave të papërfillur nga administrata perëndimore, e cila aktualisht qeverisë me Kosovën. Si rezultat i kësaj neglizhence, UNMIK-u dhe shtetet patronë të tij, kanë lejuar që zbrazëtinë ta plotësojnë agjencitë humanitare me seli në Arabinë Saudite, të cilat funksionojnë nën ombrellën e Komitetit të Përbashkët Saudit për Ndihmë Kosovës dhe Çeçenisë (SJCRC).

Aktivitetet e agjencive humanitare saudite nuk janë të panjohura për perëndimin. Një raport i paradokshëm i bërë me porosi të Pentagonit nga një hulumtues i Institutit Rand, sugjeron se kërcënimi më i madh individual për interesat amerikane dhe sigurinë afatgjatë, vjen nga Mbretëria e Arabisë Saudite. Konstatimi, ndonëse sensacional në rekomandimet e tij përfundimtare, mbështet argumentin e vet themelor mbi aktivitetet e organizatave humanitare/misionare, të cilat që nga rënia e Bashkimit Sovjetik janë shpërndarë nëpër botë. Janë dashur shumë vite, që shkollat kuranore në Pakistan të cilat kanë nxjerrë lëvizjen Talibane të tërheqin më në fund vëmendjen e të huajve.² Përballë këtij ekspozimi, është për t’u habitur se si nuk është bërë asgjë kundër themelimit të shkollave të tilla në Kosovë. Përderisa idetë e ngatërruara për islamizim të atyre që kanë marrë mbi vete administrimin e Kosovës më 1999, duket të kenë qenë shkaku i bartjes së funksioneve të ndryshme në duar të këtyre organizatave, njohuritë gjithnjë e më të mëdha lidhur me atë sesi gjatë njëzet viteve të fundit “islami radikal” është shfaqur në

shoqëritë e tilla më herët tolerante si Afganistani, është dashur të bëjë zyrtarët e UNMIK-ut të mendojnë rishtas për rolin e SJCRKC-së në Kosovë.

Këtu nuk kemi të bëjmë në veçanti vetëm me “islamit”, por me faktin se si politikën perëndimore të “zgjidhjes së konflikteve” kanë lënë në përgjithësi bashkësitë “etnofetare” (muslimanët, të krishterët ortodoksë dhe katolikët) në mëshirë të organizatave ndërkombëtare “me themele në fe”, të cilat pretendojnë të përfaqësojnë interesat më të mira të këtyre bashkësive. Janë këto organizata të cilat në mënyrë të paturpshme kanë eksploatuar varfërinë dhe kushtet e fragmentuara sociale në rastin tonë, të fshatarëve shqiptarë në Kosovë, për të ndikuar kështu në nivelin e hegjemonisë kulturore në bashkësitë të vëna në shënjestër. Si rezultat i politikave perëndimore në Kosovë, të cilat në thelb kanë larguar nga vetja adresimin e nevojave sociale dhe ekonomike pas luftës së viteve 1998-1999, duke i bartur këto çështje në organizatat, *modus operandi* themelor i të cilave është indoktrinimi fetar i popullatës. Pjesa më e madhe e shoqërisë fshatare në Kosovë po izolohet nga bashkëkombasit e tjerë dhe nga bota më e gjerë. Si pasojë e izolimit të tillë, fshatarët muslimanë në Kosovë janë gjithnjë e më të prekur nga armiqësitë që mund të pasojnë nga mu ato qeveri perëndimore të cilat nuk kanë përfillur nevojat fillestare të fshatarëve. Për ironi, përdërisa qeveritë perëndimore dridhen para “rritjes së fundamentalizmit islamik”, politikën e tyre diskriminuese ndaj popullatës fshatare muslimane mund të tregohen drejtpërdrejt përgjegjëse për prodhimin e “Talibanëve” vetanake të Evropës, të cilët më vonë, me të vërtetë mund të jenë armiqësorë ndaj “vlerave dhe interesave perëndimore.”

Përkufizimi i islamit shqiptar

Është me rëndësi të mbahet mend se shqiptarët tradicionalisht kanë praktikuar islamit në mënyra unike për rajonin, praktika këto të cilat kanë përfshirë sintezë të një varg formash vendore të traditave shpirtërore dhe të cilat përfundimisht kanë evoluuar në rituale të ndërlikuara aq sa muslimanët dhe të krishterët së bashku të shfrytëzojnë faktore të njëjta.³ Ndonëse shteti jugosllav sistematikisht përpiqej të shkatërrojë shkrirjen e tillë, duke synuar ushtrim sa më të mirë të kontrollit efektiv ndaj popullatës, ashtu sikur që në tri vitet e fundit edhe e kanë kuptuar organizatat saudite apo ato nga SHBA-të, traditat vendore në Kosovë nëpër pjesët rurale përgjithësisht kanë mbetur të paprekuara. Në përpjekjet për të ndryshuar këto veçori vendore, interesat e pasura nga jashtë (si bëmërisitë fetare), shpeshherë kanë imponuar udhërrëfimin e tyre paternalist ndaj shqiptarëve, duke supozuar se këta të fundit janë injorantë për vlerat e “vërteta” islamike, të krishtera apo “vlerat perëndimore”, gjë që kërkon një ndarje të mprehtë sektare ndërmjet besimeve. Për pasojë, shkollat, faltoret, spitalet dhe qendrat e bashkësisë, të ngritura nga “bëmëris” të ndryshëm fetarë, qeveritarë dhe joqeveritarë, gjatë tri viteve të fundit janë bërë arenë e garës për shpirtin shqiptar. Siç ka mundur të pritë, organizatat e tilla “fundamentaliste” nuk përfillin dhe shpeshherë nënçmojnë traditat

vendore të shkrirjes kulturore dhe të përdorim fjalët e UNMIK-ut, nuk përfillin dhe nënçmojnë “tolerancën për tjetrin”. Si rezultat, tensionet në rritje dhe sektarizmi i manifestuar, që më në detaje elaborohet në vijim, po bëhet i dukshëm në shumë segmente të shoqërisë kosovare, ku në të kaluarën katolikët dhe muslimanët jetonin së bashku në harmoni. Përveç nëse tensionet e tilla trajtohen që tani, ato mund të evoluojnë në labirinth ekskluzivist grupesh sektare të bazuara në fe dhe të cilat kërcënojnë çdo shpresë afatgjatë për stabilitet në rajon, veçanërisht brenda bashkësisë shqipfolëse.

Problemi qendror paraqitet si pasojë e paaftësisë së bashkësisë ndërkombëtare për të kuptuar ndërlidhshmëritë e bashkësive kosovare deri te të cilat është vështirë të arrihet. Për më tepër, përveç dështimit për të pasur konsideratë ndaj shkatërrimeve të luftës, bashkësia ndërkombëtare nuk e ka kuptuar as historinë tejet të kontestuar të trashëgimisë fetare të Kosovës.⁴ Historia e tillë kërkon një ndjeshmëri më të madhe për dallimet delikate që ekzistojnë ndërmjet traditave të ndryshme sufiste në një apo dy fshatra, dhe institucioneve të centralizuara dhe burokratike të krijuara gjatë periudhës jugosllave. Në fakt, siç u diskutua më lart, këto enklava të sufizmit në Kosovën rurale e bartën peshën e përndjekjes jugosllave gjatë periudhës pas Luftës së Dytë Botërore. Përndjekja e tillë e institucionalizuar gjatë luftës së viteve 1998-1999 përfundimisht rezultoi në sulmin shkatërrues kundër këtyre bashkësive sufiste. Me këtë rast u eliminuan shumica e xhamive, shkollave dhe prijësve të bashkësisë. Duke lejuar OJQ-të e mbështetura në fe të kenë qasje të lirë në Kosovën rurale, bashkësia ndërkombëtare në shumë mënyra ka siguruar që tepër pak nga kjo trashëgimi e sufizmit të mund të rivendoset në Kosovën e pasluftës. Për pasojë, këtu do të nxirret përfundimi se në rast se duhet bërë më shumë për mbrojtjen e traditës islame ezoterike të Kosovës, që i ka rezistuar përpjekjeve për centralizim dhe homogjenizim të besimit kosovar gjatë nëntëdhjetë viteve të fundit, sulmi i vazhdueshëm ndaj asaj që dikur ishte marrëdhënie tolerante, e larmishme dhe kryesisht provinciale me besimin e individit, do të hapë rrugën për forcat globalizuese të islamit ndërkombëtar, siç propagandohet nga forcat e lidhura me Arabinë Saudite.

Projekti jugosllav dhe sufizmi në Kosovë, 1945-1999

Se feja e personit bëhet mjet i kontrollit të shtetit bashkëkohor nuk është gjë e panjohur për lexuesin, duke qenë se për dekada të tëra “kishat kombëtare” kanë qenë mjete të shteteve në formësimin e politikave sociale në Ballkan. Megjithatë, ajo që nuk njihet përgjithësisht, është se shteti komunist, që trashëgoi mozaikun e pasur kulturor të Ballkanit pasotoman, në rajonet jugore të vendit shfrytëzoi forcat homogjenizuese në duar të veta për të ndihmuar nënshtrimin e popullatave “të rrezikshme”, shpeshherë të deklaruar si joslavë. Kjo në Jugosllavi ka qenë posaçërisht e vërtetë për sa u përket shqiptarëve. Çështja qendrore e kësaj pjese të punimit është theksimi i historisë së vonë të bashkësive islame (në shumës), me qëllim të vënies në pah të së kaluarës kur ka pasur

larmi të madhe në mënyrën se si individit ka mund të ushtrojë fenë e vet dhe se kjo larmi është gjykuar të jetë kërcënim për Beogradin, shumë ngjashëm si edhe për organizatat saudite tani. Duke vlerësuar larminë e ushtrimit të islamit në Kosovë dhe përpjekjet e Beogradit për të imponuar një “doktrinë universale” të ngurtë dhe të centralizuar përmes zyrtarëve fetarë të emëruar nga shteti, mund të kalojmë më pas në të kuptuarit më të mirë se çfarë bëjnë në Kosovë OJQ-të saudite, e ndoshta edhe të zhvillojmë strategjinë efektive për shmangien e konflikteve në të ardhmen.

Dallimet shpesh të harruara ndërmjet bashkësive muslimane (në pjesët e tjera të “botës islame” jo rallë të identifikuara nëpërmjet dallimeve sunitë/shiitë), demonstrojnë ndërlikueshmëri të trashëguar të ndërveprimit njerëzor, e cila na detyron të jemi të vetëdijshëm për përdorimin e përgjithësimeve tejet të thjeshta për islamit dhe besimtarët islamë.⁵ Është mjaft e thjeshtë që të gjithë muslimanët të futen në një thes, gjë që zakonisht edhe ndodh kur kemi të bëjmë me Kosovën, e cila nga evropianët e tjerë pothuajse gjithmonë quhet “rajon musliman”. Metodot e tilla të vrazhda të analizës bëjnë shumë pak për të na ndihmuar në të kuptuarit e tensioneve mjaft të vërteta dhe dinamike ndërmjet kësaj bashkësie, të paragjykuar si e njëtrajtshme.

Gjatë kulminacionit të Jugosllavisë komuniste, po ky qëndrim ndaj muslimanëve solli deri te përpjekjet për të kufizuar pushtetin legjitim mbi “bashkësinë islame” brenda një grupi specifik të prijësve muslimanë (*ulemave*), të cilët caktoheshin nga Beogradi për të përfaqësuar të gjithë muslimanët e Jugosllavisë. Problemi me një masë të tillë është se në mënyrë cinike fuqizonte muslimanët sllavë të Bosnjës me qëllim të shpërndarjes së islamit të centralizuar (lexo: sllavo-centrik) dhe homogjen në tërë rajonet në Jugosllavi ku jetonte popullata josllave (shqiptarët, turqit dhe romët). Centralizimi i islamit për t’u përshtatur disa qëllimeve shtetërore (homogjenizimit të identitetit gjuhësor dhe kulturor jugosllav dhe dobësimit të bashkësive “pakiçë”), shpeshherë është manifestuar në tensionime të gjata në nivelin institucional dhe etno-nacional ndërmjet muslimanëve sllavë të Bosnjës dhe pandanëve të tyre shqiptarë, romë dhe turq.⁶ Vërtetë, antagonizmi i inicuar nga përpjekja për të krijuar një “bashkësi islame” të vetme (*Islamska Zajednica*) që udhëhiqej nga *ulema-ja* e emëruar prej qeverisë, manifestohej përmes krijimit të një numri të institucioneve lokale në Kosovë të cilat kanë lënë trashëgimi që tani këtu shumë pak merret parasysh.

Tensionet thelbësore qëndrojnë në ambicjet për të kontrolluar jetën fetare të ndërlikuar e të shumëllojshme në Kosovë (dhe Maqedoni) nën patronazhin e një mekanizmi të vetëm islam, i cili do t’i raportonte drejtpërdrejt Beogradit. Në vijë me këto përpjekje për standardizim të jetës fetare të popullatës, ishte edhe përpjekja e bashkërenditur për zbehjen e karakterit josllav të Jugosllavisë. Përmes emigrimit me dhunë të muslimanëve josllavë (gjatë viteve 1948-1962 rreth 300.000 shqiptarë u larguan për në Turqi) dhe mbylljeve të shpeshta me dhunë të xhamive dhe shkollave (*medreseve*) të “palicensuara”, muslimanët turq, shqiptarë dhe romë u përballën me presione të mëdha për të braktisuar zakonet e tyre shekullore.⁷

Nga këndvështrimi institucional, problemi për Beogradin dhe aleatët e tij boshnjakë në

Sarajevë, qëndronte në faktin se “bashkësia islame” nuk ishte fare koherente. Kjo mungesë e homogjenizimit nuk duhet të shihet si befasi. Islami kishte arritur në Ballkan përmes udhëheqësve shpirtërorë rrugëtues (*shehlerë*) të cilët në periudhën e vonshme të mesjetës shpërndanin në pjesët rurale ndër popullatën e krishterë shqiptare dhe sllave. Këta *shehlerë* zakonisht ishin të ndërlidhur me rendet sufiste, praktikat “joortodokse” të të cilëve shpeshherë kalonin hendeqet doktrinare ndërmjet krishterizmit dhe islamit përmes përfshirjes së besimeve vendore në teologjinë e riformular. Për këtë arsye, Kosova deri në luftën e fundit të viteve 1998-1999, ishte vend unik për studimin e larmisë së spiritualitetit njerëzor në botën bashkëkohore, duke qenë se shumica e rendeve sufiste akoma ushtronin fenë në xhamitë origjinale të fshatit të ngritura gjatë viteve pesëdhjetë, gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë.⁸ Këto praktika të rendeve sufiste në fjalë, ishin vendore në mënyrë unike dhe pasqyronin tolerancë shpirtërore e cila pranonte dhe shpeshherë përfshinte në vete zakone vendore të krishtera, duke krijuar kështu një shkrirje të ndërlidhur të praktikave kulturore të cilat në masë të madhe dënoheshin nga institucionet serbe, greke dhe ato të islamit sunit gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë. Nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, falë homogjenizimit shpeshherë brutal të territoreve kombëtare në shtetet Ballkanike, këto praktika “joortodokse” mbijetuan vetëm në Maqedoni dhe në Kosovë dhe si të tilla ato vështirësonin përpjekjet e Jugosllavisë për kontroll më të mirë të përmbajtjes doktrimore dhe të përjetimeve të përditshme ndër bashkësitë fshatare.

Qëndrimi thelbësor i shtetit-komb bashkëkohor në Ballkan ka qenë eliminimi i “kundërtënieve” të caktuara brenda kombit, me çfarë shpeshherë janë nënkuptuar pakicat etnike dhe praktikat fetare jokonvencionale. Në Jugosllavinë e Titos, kjo përmbante në vete krijimin e *Islamska Zajednica-s* (Bashkësia Islame), e cila mbante përgjegjësinë për stërvitjen e prijesve fetarë, të cilët mandej do të kontrollonin përmbajtjen fetare, doktrinare dhe kulturore të institucioneve muslimane në vend. Themelimi i kësaj organizate në radhë të parë kishte për synim shlyerjen e larmisë së pranishme në vend, duke qenë se kjo larmi zvogëlonte aftësinë për të kontrolluar ata të cilët e mbanin fenë jashtë institucioneve të sanksionuara nga shteti. Veprimi i parë i Bashkësisë Islame në Jugosllavi, ishte vendosja e kontrollit të plotë dhe të pasfiduar mbi praktikat fetare duke ndaluar të gjitha institucionet e pasanksionuara muslimane.⁹

Më 1952, Bashkësia Islame ndaloi punën e rendeve sufiste brenda vendit, duke përfshirë në vete edhe politika agresive të mbylljes së xhamive të “paregjistruara”. Është indikative se ishin bashkësitë josllave dhe josunitë (ortodokse) të cilat u vunë në shënjestër të kësaj përndjekjeje.¹⁰ Në një masë të madhe për shkak të faktit se kjo periudhë më shumë është e njohur për përndjekjen e zhvilluar nën udhëheqjen e nacionalistit famëkeq serb, Ministrin të Brendshëm Aleksandar Rankovic, përmasat e përndjekjes dhe spastrimit të islamit në Jugosllavi kanë kaluar pothuajse të pavërejtura. Siç ka vënë re Cornelia Sorabji kohë më parë në disertacionin e saj, *Islamska Zajednica* aktivisht ka synuar të forcojë hegjemoninë e vet mbi jetën islame duke monopolizuar pretendimin në autoritet fetar dhe superioritetin vetanak akademik e shpirtëror ndaj forcave “reaksionare” në Kosovë dhe Maqedoni.¹¹ Është interesante për t’u vënë re se, përderisa

Sarajeva ka shtuar presionin veçanërisht ndaj traditave shqiptare të sufizmit, nocioni i asaj se çfarë është “jetë e përshtatshme fetare” është përputhur me atë që ishte njësi adekuate e matjes së lojalitetit politik ndaj shtetit jugosllav.¹²

Për sa i përket Kosovës kjo nënkupton një përpjekje të bashkërenditur për indoktrinim të muslimanëve shqiptarë nga ana e *Islamska Zajednica*-s. Qëllimi i parë i kësaj fushate ishte të largojë shqiptarët nga teqet sufiste të pavarura dhe tejet të lokalizuara, qoftë përmes mbylljes së tyre, qoftë duke i bindur shqiptarët në dështimin moral të këtyre teqeve. Përveç zhdukjes fizike të këtyre faltoreve, imamët e stërvitur nga *Islamska Zajednica* (prijësit shpirtërorë) ushqenin shqiptarët urbanë me dozë ditore të “doktrinës fetare” e cila vënte theksin në “bashkimin” ndërmuslimanë dhe në shpërbërjen e lojaliteteve “etnike”, gjë që u do të shndërrohej në “frymën e vëllazërimit”. Përdërisa antropologu Ger Duijzings në studimin e tij të para ca kohëve, bën një punë të mirë në theksimin e problemeve të përgjithshme ndërmjet praktikave joortodokse të sufizmit dhe përpjekjeve sunite për centralizim, ai nuk arrin të vlerësojë vetë përmbajtjen e doktrinaeve të cilat ishin në qendër të programit të viteve 1952-1962.¹³ Ndër atë të cilët janë rritur duke vijuar xhamitë e periudhës së Rankoviçit, së paku ato që funksiononin nën udhërrëfimet e miratuara nga imamët e *Islamska Zajednica*-s (lexo: Beogradit), mesazhi thelbësor ishte i qartë. Pa përrjashtim, imamët boshnjakë të cilët u dërguan në Kosovë dhe Maqedoni në vitet 1950, predikonin doktrinën e “bashkimit” prapa islamit, gjë që në veçanti vënte në shënjestër të krishterët katolikë (por jo ata ortodoksë) si armiq primarë jo vetëm të muslimanëve, por edhe të kombit jugosllav.¹⁴

Kjo është e rëndësishme pasi që politika qendrore e historianëve serbë dhe e regjimeve të dominuara nga serbët gjatë tetëdhjetë viteve të fundit, aktivisht është përpjekur të zhdukë çfarëdo prove të së kaluarës katolike në territoret jugosllave të jugut. Arsyeja qenësore për këtë është se, me zhdukjen e së kaluarës katolike, pretendimet etno-kombëtare për të kaluarën mesjetare do të bëheshin të mundshme.¹⁵ Duhet mbajtur në mend se teza për Kosovën si “zemër e Serbisë” është pretendim historik se shteti mesjetar ishte i pastërt serb dhe se Kosova ishte një tokë e zbrazët para invazionit sllav në shekullin e shtatë.¹⁶ “Problemi” qëndron në faktin se ka dëshmi për bashkësi të mëdha katolike të cilat kanë jetuar para dhe gjatë ditëve të lavdishme të Mbretërisë së Dushanit, gjë që është në kundërtënie me pohimet nacionaliste të kohës se shqiptarët erdhën në Kosovë bashkë me pushtimin otoman.¹⁷ Me qëllim të adresimit të kësaj kundërtënie ndërmjet politikës dhe realitetit, janë bërë shumë veprime për të çrrënjësuar bashkësinë katolike që jetonte në rajon. Një taktikë e përdorur ishte nxitja e armiqësisë ndërmjet popullatës shumicë shqiptare muslimane dhe bashkësisë shqiptare katolike.

Informatorët shqiptarë tregonin për predikime të cilat ndodhnin në baza ditore ndër xhamitë urbane në Kosovë dhe në të cilat në mënyrë “obsesive” theksohej kërcënimin “katolik” ndaj muslimanëve. Është e rëndësishme të përmendet se gjatë kësaj periudhe ishin para së gjithash të rinjtë ata që u vunë në shënjestër, meqë kosovarët në moshë thuhet se janë ankuar për gjuhën e përdorur nga imamët boshnjakë në çnderim të të afërmeve të tyre dhe të fqinjve të tyre katolikë.¹⁸ Prandaj, ishin fëmijët e edukuar në

medresat e sanksionuara nga shteti, të cilëve u rrëfeshin tregime për praktikat “demonike” të katolikëve, tendencat kanibaliste të priftërinjve dhe shpifje historike të kishës ndaj muslimanëve dhe shqiptarëve. Një arsim i tillë përfundimisht la përshtypje të thellë te një numër i muslimanëve të rinj kosovarë të cilët, bazuar në shumë burime të shfrytëzuara për këtë projekt, gjatë viteve 1960 publikisht kanë përjashtuar nga jeta e tyre e përditshme shqiptarët katolikë. Rezultati i këtij animoziteti është migrimi masiv i katolikëve shqiptarë nga Kosova dhe pak a shumë një segregacion gati i plotë ndërmjet dy “bashkësive” në Kosovën urbane.¹⁹

Është e qartë nga bisedat e mia me persona që janë arsimuar gjatë kësaj periudhe, se një vijë e veçantë e argumentimit nga imamët boshnjakë ishte e njëjtë në mbarë Kosovën. Është thënë se imamët boshnjakë, dhe më pas edhe ata shqiptarë të stërvitur në Sarajevë, predikonin se besimi ortodoks serb është në të vërtetë “i afërt” me islamën dhe se serbët janë më të prirur për t’u konvertuar në islam sesa katolikët shqiptarë.²⁰ Poenta ishte se shqiptarët muslimanë duhet t’u besojnë më shumë fqinjve të tyre serbë se sa shqiptarëve katolikë, të cilët ishin aq “ndryshe” sa që gjasat që këta të pranojnë “fenë e vërtetë” [islamën] ishin baraz me zero. Fakti se gjatë viteve 1950 dhe 1960 kjo metodë e indoktrinimit ishte e njëjtë në Prizren, Gjakovë dhe Pejë, sugjeron se Sarajeva formulonte dhe zbatonte strategjinë e ndryshimit në masë të lojalitetit të shqiptarëve muslimanë.²¹

Është interesante për të vëne re se kjo strategji përgjithësisht ishte e suksesshme në bashkësitë ku Bashkësia Islame e Sarajevës ushtronte kontroll efektiv, përkatësisht në pjesët urbane të Pejës, Gjakovës, Mitrovicës dhe Prishtinës. Duhet theksuar se ky animozitet nuk kishte bazë historike, duke qenë se hulumtimet për periudhën otomane tregojnë se familjet kosovare shpeshherë përbëheshin nga anëtarë katolikë dhe muslimanë njëkohësisht.²² Se tensionime të tilla nuk kishte para periudhës jugosllave, theksohet edhe më shumë kur vërehet suksesi demografik i kësaj politike për eliminimin e trashëgimisë katolike në Kosovë. Regjistrimi i vitit 1921, i zhvilluar nga Serbia, tregon se 27.8 përqind e popullatës shqiptare (e cila përbënte 64,1 përqind të gjithë popullatës) atëbotë identifikoheshin si katolikë.²³ Fakti se katolikët sot përbëjnë vetëm 5 përqind të popullatës së Kosovës tregon qartë përmasat e presionit gjatë këtij shekulli Beogradi ushtronte ndaj bashkësive katolike në Kosovë.²⁴ Ajo që gjithashtu bie në sy, është fakti se përderisa bashkësitë e mëdha katolike në Pejë, Gjakovë dhe Prizren pothuajse që të gjitha ishin larguar, ishin bashkësitë katolike fshatare ato të cilat kishin mbijetuar duke qëndruar pranë fqinjve të tyre muslimanë. Besoj se një pjesë e madhe e bashkëjetesës së këtyllë pasqyron ndikimin minimal të imamëve të Sarajevës në Kosovën fshatare dhe mbizotërimin e rëndeve tolarante sufiste.

Gjatë gjithë periudhës së Titos, muslimanët shqiptarë ruralë në Kosovë kanë rezistuar përpjekjet e Sarajevës për centralizim dhe rrjedhimisht edhe rendet sufiste arritën të mbijetojnë. Në pjesët urbane, nga ana tjetër, kontrolli policor dhe zbatimi i përpiktë i “lejeve” ndihmonte në mbylljen e xhamive dhe medreseve të pasanksionuara. Si përgjigje ndaj kësaj përndjekjeje nga Sarajeva, rendet të cilat mbijetuan në Kosovë u bënë gjith-

një e më aktive në adresimin e përpjekjeve të Sarajevës për centralizim, duke tërhequr në këtë mënyrë edhe shumë ithtarë nga pjesët urbane.²⁵ Informatorët bëjnë me dije se kishte organizata sekrete të cilat mobilizonin bashkësitë për të ndihmuar financimin dhe për të mbrojtur gjatë shekujve shumë nga këto faktore. Vetë fakti se këto bashkësi ishin të afta për të mbijetuar gjatë periudhës së Rankovic-it, tregon për një nivel të lartë të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe atyre që ato përfaqësonin. Ky nivel i aktivizimit ndër bashkësitë rurale gjithashtu pasqyron rolin qendror të cilin e luanin rendet sufiste në jetën e përditshme të shumicës së shqiptarëve të Kosovës, rol ky të cilin Beogradi në çdo mënyrë përipiqej që ta eliminojë.²⁶

Me ndryshimet në pushtetin politik në Jugosllavi gjatë fazës së fundit kushtetuese më 1974, këto rrjete nëntokësore dolën në sipërfaqe në formë të shoqatës së rendeve sufiste (dervishe) (*Bashkësia e Radhëve Dervishe Islame Alije*, në tekstin e mëtejme BRDIA), e cila udhëhiqej nga Sheh Xhemali Shehu i teqes Rufai në Prizren. BRDIA, e poshtëruar nga udhëheqësit islamë në Sarajevë, shumë shpejt u bë forcë kulturore në jetën publike të Kosovës, duke qenë se vendorët mblihdeshin në këto institucione shqiptare. Publikimi i BRDIA-s, *Buletini HU*, një burim i tejet i çmueshëm për përpjekjet e shumta të organizatës në zhbërjen e praktikave të tmerrshme dhe kryesisht përçarëse të 25 vjetëve të fundit, gjithashtu ndihmoi në përhapjen e mesazhit tek dhjetëra mijëra lexues të Kosovës urbane. Deri më 1984, 126 njësi sufiste në mbarë Kosovën iu bashkuan BRDIA-s, duke përfaqësuar 50.000 dervishë, të cilët deri më 1998, siç pohon një sociologe serbe nga Prishtina, arritën një anëtarësi të supozuar prej 100.000 personash.²⁷ Këto shifra, ndonëse spekulative, megjithatë japin një përshtypje të përmasave të kësaj dukurie dhe të pasurisë së jetës islame kosovare para viteve 1998-1999. Është indikative për shqetësimet e shtetit, se ndër rendet të cilat vepronin në Kosovë deri nga mesi i viteve 1990 (Rufai, Kaderi, Halveti, Sadi, Bektashi, Nakshibendi, Sinani, Mevlevi dhe Shazili), që të gjitha nga Sarajeva janë gjykuar si “joislame”.²⁸

Sërish, ndikimi i këtyre rendeve në bashkësitë vendore ishte i gjërë, prandaj edhe këtu buronte frika e Beogradit dhe Sarajevës. Është me rëndësi të përmendet, se ky ndikim, gjithashtu shihej si kërcënim edhe për BIK-un me seli në Kosovë, e krijuar në vitet 1960 me qëllim që të shërbejë si një dorë e zgjatur e Sarajevës. Gjatë viteve 1970 dhe 1980, anëtarët e BIK-ut, haptazi kanë akuzuar *shehlerët* vendorë sufi për “grabitjen” e besimtarëve nga xhamitë ortodokse sunitë dhe në shtypin kryesor në mënyrë agresive kanë stigmatizuar teqet për misticizëm dhe primitivizëm.²⁹ Është e rëndësishme, se përpjekjet për të zbutur ndikimin e rendeve sufiste kanë pasur pasoja politike si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës. Ishte e qartë gjatë gjithë periudhës së pas Luftës së Dytë Botërore se funksioni qendror i Sarajevës ishte të spastrojë popullatën shqiptare në Kosovë, e cila tërësisht shihej si kërcënim për Beogradin.³⁰ Prandaj, Sarajeva haptazi dënonte *shehlerët* sufi në Kosovë duke i konsideruar kërcënim për “harmoninë”, sikundër edhe për praktikat e mira islame.³¹ Deri kah marsi i vitit 1979, kur Bashkësia Islame organizoi një takim për t’u marrë me këtë problem, edhe gazetarët serbë haptazi nacionalistë iu rrekën veprimeve të sulmit ndaj rendeve sufiste të shqiptarëve, duke plasuar akuza për alkoholizëm, vjedhje, “sjellje jopatriotike”, primitivizëm dhe mëkate tjera.³² Fushata që

pasoi në mediat serbe për stigmatizim të sufistëve shqiptarë si një problem primar për rajonin, qartazi lidhte historinë e gjatë të përpjekjeve të Sarajevës për eliminim të larmisë fetare në Kosovë me shqetësimet të mbetura nacionaliste të një numri të madh në Beograd.³³

Sërish, burimi i frikës ishte roli organizues i rendeve sufiste në shoqërinë fshatare në Kosovë. *Shehlerët* sufi tradicionalisht kanë luajtur rolin e ndërmjetësuesve në bashkësi, kurdo që janë paraqitur konteste. Me fjalë të tjera, roli qëndror shpirtëror shtrihej edhe në rol socio-politik, që konsiderohej të jetë esencial për funksionimin e shoqërisë rurale kosovare, në masë të madhe të izoluar nga pjesa tjetër e Jugosllavisë. Ky rol, krijonte një kërcënim afatgjatë ndaj përpjekjeve të Beogradit për vendosje të kontrollit më të madh në pjesën rurale të Kosovës. Këtu qëndron rrënja e historisë së gjatë të qeverisjes lokale dhe të vetëmbështetjes së Kosovës. Ajo nuk është mbështetur vetëm në strukturat që pretendoheshin nga LDK-ja, por në rrjetet shpirtërore të mbajtuara nga rendet sufiste.³⁴

Mu për shkak të ndikimit të dukshëm të shehlerëve sufi dhe të teqeve në shoqërinë fshatare, lufta e viteve 1998-1999 mori nuansat “anti-islamike”. Në veçanti u vunë në shënjestër rendet sufiste, të cilat për shekuj të tërë kanë përbërë themelin e shoqërisë shqiptare në Kosovë. Në kulminacionin e fushatës serbe në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, ishin rendet sufiste, xhamitë e tyre qindvjeçare, medreset dhe vetë *shehlerët* që u eliminuan. Ishte e qartë se Millosheviqi, Shesheli dhe elita nacionaliste serbe, ishin të interesuar për eliminimin e përhershëm të bashkësive sufiste në Kosovë, meqë ishin këto që ndihmonin në mbajtjen e bashkësisë kosovare fshatare. Bie fjala, mu në fillim të ofensivës në korrik të vitit 1998, caqet primare të Beogradit ishin prijësit e rendeve sufiste. Sheh Muhedini, udhëheqës i rëndësishëm shpirtëror në teqen Helveti në Rahovec, derisa po lutej u vra nga forcat policore serbe. Vdekja e Muhedinit shënoi fillimin e fundit të historisë prej gjashtëqind vitesh të sufistëve në Kosovë, dhe, sikundër edhe pothuajse e tërë trashëgimia tjetër shqiptare, realitetet e pasluftës nuk kanë bërë pothuajse asgjë që këto të kthehen.³⁵

Çrënjosja e një elementi kaq themelor të Kosovës rurale sot është burim i mundshëm i jostabilitetit në bashkësitë fshatare të Kosovës. “Establishmenti fetar” i Kosovës që nga lufta në masë të madhe është dëmtuar për shkak të eliminimit fizik të pjesës më të madhe të themelit historik shpirtëror të Kosovës. Fakti se kjo traditë shpirtërore ishte shumë më tolerante ndaj larmisë kulturore dhe ngërthente në vete nocione të shumta të bashkëjetesës ndërsektare, sesa islami i propaganduar nga agjencionet humanitare saudite që sot përpiqen të dominojnë jetën shpirtërore të Kosovës, vetëm sa u jep vendim-marrësve politikë perëndimore një arsye më shumë për shqetësim. Në shkatërrimin e pësuar nga Kosova rurale, bashkësia ndërkombëtare ka bërë shumë pak për adresimin e këtyre zbraztësirave shpirtërore që rezultojnë nga problemet afatgjata në rajon.

Për ironi, në kohën kur elita vendore sunite, siç është identifikuar nga Rexhep Boja dhe Sabri Bajgora, do të mund të plotësonte këtë vakum, vetë BIK-u kishte pak burime materiale nga ato që nevojiteshin për të ndihmuar rindërtimin e infrastrukturës fetare

dhe arsimore. Organizatat bëmirëse saudite, nga ana tjetër, janë padyshim të pajisura më mirë se sa që mund të mendohet. Efikasiteti me të cilin SJCRKC-ja i është rrekur plotësimi të vakumit, vë në pah një agjendë të sofistikuar dhe globale, të ngjashme me atë të një korporate multinacionale e cila përpjehet të dominojë pjesën e vet të tregut. Është raportuar se SJCRKC-ja ka shpenzuar katër milionë rijalet saudite (rreth 500.000 dollarë amerikanë) për sponsorimin e 388 “propaganduesve” fetare (gjegjësisht misionarëve) të cilët kanë udhëtuar nëpër Kosovë menjëherë pas luftës.³⁶ Ajo çfarë kanë bërë këta (do t'i quaja ekspertë për vlerësim të gjendjeve të pasluftës) ishte identifikimi i bashkësive më të prirura për të pranuar “ndihmën” e tyre. Bazuar në hulumtimin e tyre të Kosovës fshatare, sot kemi një rrjet të elaboruar dhe të bashkërenditur mirë të kontrolluar nga vebabitët në bashkësitë fshatare, lidhja e vetme e të cilave me botën e jashtme është përmes OJQ-ve saudite.

Monopolizimi pasues i ndihmës ndaj atyre në bashkësitë deshpërueshëm të varfëra dhe të shkatërruara, shumë nga të cilat kanë mbetur pa meshkuj madhorë, po i paguan dividenda afatgjata interesave saudite. Por, a janë interesat e sauditëve të njëjta me interesat e kosovarëve? Këtu sugjerohet se ato nuk janë të njëjta. Çështja qendrore e hulumtuar më poshtë në detaje, është se vebabizmi saudit me shpejtësi është duke e ndryshuar shoqërinë kosovare. Duhet vënë re se në shumë aspekte, organizatat saudite të lejuara nga bashkësia ndërkombëtare që pa ndonjë mbikëqyrje të veprojnë në Kosovë, kanë demonstruar të njëjtën jotolerancë institucionale ndaj traditave fetare të Kosovës, sikurse edhe *Islamska Zajednica* e Beogradit në periudhën 1945-1991. Se trashëgimia e fundit fetare e Kosovës është duke u rrafshuar me tokë nga organizata të cilat kanë ambicje hegemone të ngjashme me pandanët jugosllavë, duhet të jetë akuzë e hidhur për kalkulimet e gabueshme të bashkësisë ndërkombëtare dhe të Evropës dhe për sentimentet e fuqishme antimuslimane.

Të kuptuarit e doktrinës vehabite

Burimi i tensionimeve të manifestuara ndërmjet udhëheqësisë së mbetur vendore muslimane, të mishëruar sot në Rexhep Bojën (jo i traditës sufiste) dhe të “arabëve invadues”, është një doktrinë specifike teologjike që eksportohet nga agjencitë bëmirëse saudite. Këto organizata saudite, të mbështetura në mësimet e doktrinës me origjinë nga Arabia e shekullit të tetëmbëdhjetë (që aktualisht paraqet ideologjinë shtetërore të Arabisë Saudite), në mënyrë aktive kanë synuar të indoktrinojnë dhe të shpërndajnë atë që shumica e njerëzve të botës islame e konsiderojnë të jetë “fundamentalizëm” armiqësor dhe i ngurtë. Për ironi, përpjekjet e SJCRKC-së për të kontrolluar përmbajtjen e jetës shpirtërore të shqiptarëve, shkatërrimet e saj të financuara të shumë objekteve historike të gjykuara si frymëzuese të “idhulltarisë” dhe sulmet e tjera ndaj formave burimore të praktikës fetare, kanë rezultuar në sfidime publike të disa prej atyre që janë aq armiqësorë ndaj sufizmit sa edhe vetë sauditët. Ajo që duket se bashkon Rexhep Bojën

dhe atë që ka mbetur nga tradita sufiste në Kosovë, është politizimi i islamit nga ata që janë lojalë të Arabisë Saudite. Çfarë shkakton shqetësime ndër këta shqiptarëve të vetë-identifikuar është ndikimi që ka doktrina vehabite në lojalitetin e të arsimuarve nëpër shkollat e SJCRKC-së. Ka bregë të arsyeshme se shumë nga lojalistët vehabitë në Kosovë, janë duke drejtuar interesat e kosovarëve të rinj e të ndjeshëm në agjenda politike të cilat shkojnë shumë më larg se ushtrimi i besimit.³⁷

Me qëllim që të vlerësohet më mirë se çfarë mund të pritet në të ardhmen nga këta lojalistë vehabitë, është e nevojshme që në mënyrë kritike të shikojmë vetë lëvizjen si të tillë. Lëvizja vehabite u paraqit në rajonin jugor arab të Najd-it nga fundi i shekullit tetëmbëdhjetë, nën udhëheqjen e Muhammad b. ‘Abd al Wahhab, i cili mëtonte të sfidojë qarqet e pushtetit në Stamboll dhe Damask. Lëvizja menjëherë u dënua nga elita fetare dhe politike e Damaskut, e cila e shihte ‘Abd al Wahhab-in si një debitant më tepër në përpjekjet për të kërcënuar rendin e vendosur në Lindjen e Mesme Otomane. Në veçanti, elita islame në Damask dënonte doktrinën radikale të ‘Abd al-Wahhab-it sipas së cilës secili që nuk pasonte mësimet e tij konsiderohej *takfir* (jobesimtar).³⁸ Me zgjerimin e lëvizjes, qëndrimi jotolerant ndaj të tjerëve u bë shqetësim i madh për shumë udhëheqës fetarë në vende shumësektare, si Aleppi, Damasku, Bagdadi, Basra dhe Jerusalemi, duke qenë se cilado doktrinë që predikonte eliminim agresiv të praktikave “joislamike” kërcënonte harmoninë ndërmjet bashkësive. Ky kërcënim për stabilitetin e Lindjes së Mesme Otomane në shekullin e tetëmbëdhjetë tani duhet të kuptohet ngjashëm edhe në Kosovë.

Vetë ‘Abd al-Wahhab-i përkushtoi një pjesë të madhe të energjisë zbrapsjes së akuzave kundër tij, në veçanti të pohimeve se ai synonte të tejkalojë katër shkollat e së drejtës sunite.³⁹ Vërtetë, kishte mjaft paqartësi për pikat e besimit vehabit.⁴⁰ Misteria vinte kryesisht nga fakti se punimet e ‘Abd al-Wahhab-it deri kohë më parë ishin shumë pak të njohura jashtë Arabisë.⁴¹ Në bazë të injorancës së tillë, akademikët islamikë kanë nxitur më shumë polemikën anti-Vahebi, duke denoncuar verbërisht ideologjinë e ndërlidhur të lëvizjes Vahebi në vënien e demarkacionit absolut ndërmjet pushtetit vetanak në zgjerim e sipër dhe të gjithë asaj që e rrethon.⁴² Ngurtësitë e tilla në interpretim, edhe sot madje, nuk përshtaten mirë me larminë fetare të Lindjes së Mesme. Natyrisht, nervoziteti i shprehur për qëndrimet shoviniste vehabite ndaj të tjerëve, është shndërruar po ashtu në mosbesim të përgjithshëm të perëndimorëve ndaj lëvizjes.

Është me rëndësi se fakti që polemika për vehabitët shpesh keqkuptohet nga “të jashtmit”, përdoret në masën më të madhe nga pasuesit e lëvizjes. Siç do të shihet më poshtë, strategjia e miratuar e “mbrojtjes ofenzive” e ndërmarrë nga pjesëtarët e lëvizjes vehabite mobilizon “mentalitetin e rrethuar” ndër lojalistët, që rezulton në mosbesim të intensifikuar dhe armiqësi të dhunshme ndaj të huajve. Armiqësia e tillë shtrembërohet në mësimet e lëvizjes në vende si Kosova dhe ndjenja e lartë e lojalitetit ndaj lëvizjes shprehet në gjithçka që bën pjesëtarin. Kjo qasje mbrojtëse e ngurtë dhe kokëfortë është vendimtare për të kuptuar sot ndikimin e vehabizmit në Kosovë, duke qenë se gjasat për dialog janë mbyllur nga ndjenja e vetëimponuar e përndjekjes.

Dimenzioni social dhe politik i ideologjisë vehabite që paraqet thelbin në vlerësimin e qëllimeve të tij në Kosovë, është vënia e kufijve të përpiktë të ekskluzivitetit ndaj identitetit të veçantë ‘*asabiyya*’ (grupor). Roli qendror i praktikuesve të doktrinës së ‘Abd al-Wahhab-it, është se çdo gjë që është jashtë territorit social, politik dhe gjeografik në zgjerim e sipër të ‘*asabiyya*’ (grupit vehabi) paraqet cak legjitim për nënshtrim. *Kufyr* [jobesimtar] është atribut për të tjerët dhe, në formën e theksuar vehabite, i të tjetrit të pastër dhe të thjeshtë. Doktrina e tillë, sipas shkrimeve të vehabitëve prominentë që nga shekulli i nëntëmbëdhjetë, e bën pushtimin dhe nënshtrimin nën flamurin e termit të keqkuptuar të xhihadit të bartur nga pjesëtarët e lëvizjes.⁴³ Kjo gjendje ndërvepruese me botën e jashtme, shihet edhe si veprim politik i zgjerimit të pushtetit dhe si një obligim juridik-fetar.

Qenësore për të kuptuar doktrinën e ‘Abd al-Wahhab-it është se e jashtëmja e *kufyr-it* përfshin jo vetëm fetë idhulltare, dhe nuk është e kufizuar në monoteizmat joislamë, por përkshkruan edhe vehabitët muslimanë gjithashtu. Vetë ‘Abd al Wahhab-i ka potencuar këtë, duke arsyetuar dallimin përmes analogjisë me profetin Muhamet që gjatë viteve të para të islamit luftoi “besimtarët në një Zot”.⁴⁴ Parimi i shenjtë i islamit sunit, sipas të cilit të gjithë ata që predikojnë *shabada* [veprim apo besim rituali] janë muslimanë, në këtë mënyrë mohohet nga vehabitët në favor të domosdoshmërisë për të luftuar kundër të gjithë muslimanëve të cilët nuk pranojnë mësimet vehabite.⁴⁵ Në shkrimet e Sulayman b. Abdallah b. Muhammad b. ‘Abd al Wahhab, pauses me ndikim i themeluesit të lëvizjes, vehabizmi jo vetëm që ndalon aleancë me *kuffar* [jobesimtarët], por gjithashtu edhe punësimin, këshillimin, besimin, vizitën, emulacionin, përzemërsinë dhe njerëzishmërinë ndaj tyre.⁴⁶ Kjo, në kontekstin aktual, do të thotë se agjencitë “humanitare” saudite praktikisht zbatojnë doktrinën të një izolimi të plotë të bashkësisë që jo vetëm se i sheh të krishterët dhe paganët si të tjerë e të padëshiruar, por njësoj i sheh edhe muslimanët e tjerë të cilat nuk u nënshtrohet parimeve të tyre të interpretimit. Madje, që është edhe më keq, supozimi qenësor i vlerave të tyre superiore do të thotë se ata janë të detyruar të shkatërrojnë aktivisht të gjitha format e tjera të shprehjes shpirtërore, sërish, jo vetëm ato të krishtera, por edhe format “vendore” muslimane. Duke u dhënë pushtet të lirë këtyre organizatave, bashkësia ndërkombëtare ka ftuar për shkatërrim të traditave tradicionalisht tolerante dhe idiosinkratike në Kosovë. Janë këto bashkësi që deri më 1999 fuqishëm kanë ngrëthyer në vete traditat sufiste, e të cilat tani janë të detyruara të miratojnë qëndrime të ngurta, dhe madje mund të thuhet edhe të skajshme, për botën, në rast se dëshirojnë të gëzojnë “ndihmën” bujare nga e vetmja organizatë humanitare që vepron në fshatin e tyre.

Në botën aktuale, kjo do të thotë se Arabia Saudite shfrytëzon doktrinën të ngurtë dhe konfrontuese për të legjitimuar fushatën agresive ekspansioniste të indoktrinimit në ish Bashkimin Sovjetik (Azi Qendrore dhe Kaukaz), Azi Juglindore, Afganistan dhe Evropë. E armatosur me miliarda dollarë nga nafta, sulmi kundër islamit tradicional në Ballkan, që siç u përmend më lart, më parë ishte i mbështetur në tolerancë dhe sikretizëm, po fillon të shkaktojë ndarje të rënda, ndonëse tani jo shumë të vërejtura, brenda bashkësisë fetare në Kosovë. Se një vend aq i afërt me Shtetet e Bashkuara të

Amerikës aktivisht promovon këtë doktrinë konfrontuese të ekspansionit në pjesët fshatare, është një indikacion i asaj se sa të painformuar dhe mendjengushtë ishin planifikuesit e hershëm të përgatitjeve të pasluftës. Se UNMIK-u dhe agjencitë e ndryshme qeveritare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Evropës, edhe pas 11 Shtatorit 2001 vazhdojnë të lejojnë këto organizata të përkushtuara për monopolizim të “ndihmës” në pjesët rurale me kapacitet të dobët rezistues, pasqyron injorancën e vendim-marrësve perëndimorë për sa i përket rajonit dhe islamit.

Arsyet pse vehabitët janë aq të zellshëm në shkatërrim të asaj që e konsiderojnë të jetë jashtë sferës së praktikave të pranueshme, janë të lidhura me supozimet politike të vendit të tyre në skemën e gjerë të botës. Për vehabitët e kohës së tashme, diapazoni retorik dhe praktik i doktrinës së tyre është qartazi i eksportueshëm. Çështja për shumë nga ata që kundërshtojnë politikat saudite brenda botës islamike është pyetja se çfarë i bëjnë praktikat dhe doktrinat e tilla të “papastra” shëndetit të islamit. Nga ana tjetër, për vehabitët e hershëm, traditat vendore fragmentojnë autoritetin fetar të botës, duke rënë ndesh kështu me vendosjen e pushtetit politik, i cili supozohet se në botën moderne mbahet nga aleanca saudito-vehabite.⁴⁷ Prandaj, çfarë kemi në fillim të shekullit njëzet e një, është një shtet modern që merr mbi vete detyrën hyjnore të shpërndarjes së islamit vehabi në pjesën tjetër të botës dhe që eliminon të gjitha manifestimet e tjera të “papastra”.

Me të vërtetë, nga monitorimi i aktiviteteve saudite në Azi Qendrore, Afrikë, Ballkan dhe shtetet fqinje arabe, është e qartë se aktivisht kërkohet përdorimi i forcës së teknologjisë dhe pasurisë së saj të madhe ekonomike për të projektuar doktrinën ekspansioniste dhe jotolerante në rajonet e varfëra të botës. Al-Qa’ida është vetëm një manifestim militant i këtyre rrymave nënsipërfaqësore të botës. Në zemër të Prishtinës, në cilëndo natë, brenda selisë së SJCRKC-së në Dardani, sesionet “trajnuese” për femra shoqërohen me ligjërata për superioritetin e kulturës arabe dhe nevojën e kthimit të sjelljes shembullore të muslimanëve të parë. Sipas një informatori që kohëpaskohe merr pjesë në këto sesione, një e re nga Drenica (e supozuar të jetë nga atje në bazë të dialektit), tani studente në shkollën e teologjisë në Sarajevë, përpigjet t’i bindë shqiptaret e tjera se, ndër të tjera, Skenderbeu ishte tradhëtar i islamit, se themeli i historisë juridike shqiptare, Kanuni i Lekë Dukagjinit, nuk është burimor, por se janë sjellë nga arabët të cilët kanë ardhur në Kosovë qindra vjet më parë, dhe se për t’u bërë muslimanë të vërtetë ato duhet të pranojnë stilin e jetës së arabëve të shekullit të shtatë. Kjo formë kureshtare e angazhimit të njerëzve të cilët për të gjitha qëllimet dhe synimet nuk pajtohen me atë që dëgjojnë, u përshtatet në mënyrë të përkryer perceptimeve metodologjike të nxjerra nga tekstet themelore doktrinare të lëvizjes vehabite.⁴⁸

Çështja këtu nuk ka të bëjë me “faktet” historike, por për temën thelbësore të nënshtrimit të plotë ndaj një shovinizmi etno-centrik i maskuar prapa mbuluesës së fesë universaliste. Vehabizmi kërkon nënshtrim në parim ndaj pushtetit të tij, pushtet ky pa dyshim i përqëndruar në Oborrin Mbretëror të Sa’ud-ëve, prej nga buron e gjithë kultura që vlen të mbrohet. Kjo doktrinë vë përpara një model detyra e të cilit është t’i bëjë

shoqëritë vendore, si Kosova, objekt të zakoneve, autoriteteve, devotshmërisë dhe veçantive të tjera arabe të Najd-it.⁴⁹ Çfarëdo shprese për anëtarësim në këtë bashkësi ekskluzive duhet të fillojë me pranimin e nocionit se kultura dhe historia shqiptare është qoftë e pavlefshme, qoftë se aspektet më të mira të saj duhet të përfshihen në histori si pjesë ekskluzivisht të lidhura me Arabinë.

I tillë është importi i abstraktimit nga realiteti bashkëkohor që karakterizon gjithë fundamentalizmin: mungesa është e konstruktuar, dhe ajo më pas plotësohet me interpretime nga ata që kanë mjetet për të jetësuar interpretimin. Në fshatrat e Kosovës, është SJCRC-ja që ka këto mjete, duke qenë se ofron ushqim, punë dhe shpresë për jetë më të mirë materiale. Në Prishtinë, ekziston liria për t'u larguar dhe për të vijuar dikund tjetër kursin e rrobaqepësisë, prandaj edhe ka pak femra të cilat janë bindur në këtë qasje. Ky është dallimi themelor ndërmjet botës që e përjetojnë shumica e pjesëtarëve të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë dhe pjesës më të madhe të popullsisë së rajonit. Taktika e vehabitëve sot është përkujdesja që të mbetet hapur dera retorike për kontekstet sociale dhe politike të doktrinës së tyre, në mënyrë që të ndërliiden me realitetet bashkëkohore të popullatës dëshpërueshëm të varfër të Kosovës. Kjo kryen punë mirë në gjendjet si kampe refugjatësh dhe në vende fshatare të shkatërruara nga lufta, e jo aty ku njerëzit kanë mundësi për të zgjedhur.

Është me rëndësi për të vënë re se kjo dukuri nuk është unike vetëm për islamin dhe, në të vërtetë, besimi i islamit ashtu siç praktikohet nga shumica dërmuese në botë, nuk promovon shprehimisht sjellje të tillë. Përkundrazi, atë që së pari Bashkësia Islame dhe qeveria jugosllave më herët, ndërsa tani sauditët përpiqen të bëjnë, është homogjenizimi i larmisë inherente të islamit me qëllim të kontrollit të burimeve të tij të mëdha sociale. Duke shfrytëzuar forcën e teknologjisë, kapacitetet e pakrahueshme të shtetit dhe injorancën e botës perëndimore, SJCRC-ja dhe organizatat e tjera “humanitare” të financuara nga sauditët, lehtëzi janë duke vendosur themele të forta ndër popullatën fshatare në rritje.

Dallimet në krahasim me përpjekjet në të kaluarën për homogjenizim të rajonit qëndrojnë në faktin se këto agjenci saudite do të zhvendosin qendrën e pushtetit jashtë rajonit. Me fjalë të tjera, identiteti i ardhshëm kosovar nuk do të jetë ai që lehtë kontrollohet nga forcat politike me seli në Prishtinë, apo qoftë edhe dikund tjetër në rajon. Tema qendrore e doktrinës vehabite është pohimi universalist i besimit, i tillë që nuk njeht vendoren dhe thekson vetëm shtrirjen globale të doktrinës vetanake. Fakti se qendra e kësaj doktrine të islamit universal është Rijadi, do të thotë se pas dhjetë viteve kur lufta të fillojë dikund në “botën islame”, lojalitetet vendore shqiptare do të sfidohen. Militantizmi mund të manifestohet në Kosovë shumë ngjashëm sikurse edhe vizioni i “Talebanëve” për botën që është krijuar nga hiri i shoqërisë afgane, e ngritur përmes të hollave saudite në kampet e refugjatëve në Pakistan. Shumë ngjashëm sikurse edhe luftërat shkatërruese në Afganistanin passovjetik që zhvilloheshin ndërmjet atyre që praktikonin islam “të papastër” (Aleanca Veriore) dhe atyre që praktikonin doktrinën vehabite (Talibanët), e njëjta ka mundësi që të ndodhë edhe në Ballkan. Atë që sot e vërejnë në Kosovë është

themel potencial për Liban të ri, apo edhe më keq, për krijim të grupeve të fuqishme fshatare, vetidentifikuese e të ngjashme me Talibanët, të cilat nuk do të tolerojnë dalime fetare dhe doktrinoe.

Identifikimi i krizës

Për fat të keq, marrëdhëniet ndërmjet UNMIK-ut dhe popullsisë në të cilën ka mandatin ta qeverisë, janë injoruar në botën e pas 11 Shtatorit 2001, duke rezultuar kështu në disa tensionime kritike të cilat janë lejuar të përkeqësohen. Siç kam përmendur më parë, vendimmarrësit evropianë dhe amerikanë, historikisht kanë demonstruar tendencë për mospërfilljen e dinamikave sociale të shoqërive si Kosova, me qëllim të arsyetimit të interesave më të mëdha politike, gjë që shpeshherë nuk do të thotë asgjë tjetër, veçse dëshirë për “stabilitet.”⁵⁰ Për sa i përket Kosovës, administrimi i dështuar i UNMIK-ut karshi nevojave të pasluftës në Kosovë, ka rezultuar në formësim të forcave të reja politike dhe sociale, të cilat për ironi, janë tejet të dëmshme për stabilitetin afatgjatë të Evropës. Në pjesët e shkatërruara nga lufta, ku sipas të dhënave të Bankës Botërore, më shumë se 50% të kosovarëve jetojnë në varfëri, OJQ-të sekulare dhe UNMIK-u kanë dështuar të adresojnë nevojat vendore. Në vend të tyre, bëmërsitë evangjeliqe kanë qenë dyshueshëm aktive në plotësimin e kësaj zbratësire. Këto organizata, të lidhura me forcat politike që nuk kanë të bëjnë asgjë me interesat vendore, po vëjnë në jetë shtigje të reja të lidhjes që kërkon orientimin e lojalitetit përtej rajonit.

Çfarë është më shqetësuese, shumë nga këto organizata të huaja kanë përfituar nga antipatia e krijuar përballë sjelljes indiferente të bashkësisë ndërkombëtare, duke lidhur ideologjitë antiperëndimore me shqetësimet vendore të të qenit i izoluar nga pjesa tjetër e Evropës. Organizatat të cilat funksionojnë nën ombrellën e SJCRKC-së e të cilat po lulëzojnë në pjesët e shkatërruara rurale të Kosovës, jo vetëm që kanë monopolizuar dhënien e ushqimit dhe të shërbimeve mjekësore ndaj popullatës, por kanë monopolizuar gjithashtu edhe arsimimin e tyre. Në këtë aspekt, kushtet e Kosovës rurale u ngjajnë atyre të vërejtura përgjatë kufirit afgan në vitet 1980 dhe 1990, kur një numër i madh i familjeve me të veja dhe jetimë ishin të varur nga lëmusha saudite. Në të vërtetë, mekanizmi i dukurisë së “talibanëve” (në kuptim tekstual, student) në Pakistan do të gjente shumë më tepër paralele me Kosovën rurale, paralele këto që do të duhej të jenë arsye për shqetësim ndër vendimmarrës, përderisa SJCRKC-ja zgjeron ndikimin e vet në rajon.

Tepër pak vëmendje i është kushtuar llojit të ndihmës, përfshirë atë arsimore, që organizatat fetare u ofrojnë fëmijëve kosovarë mbi moshën trevjeçare. Fondacioni Bëmërs Islamik (IEF), që vepron nën ombrellën e SJCRKC-së, haptazi pranon se përkrah mbi 30 shkolla kuranike në pjesët rurale të Kosovës, që të gjitha të ndërtaura pas vitit 1999.⁵¹ Vendorët, kur janë pyetur për këto shkolla, janë ankuar se mësojnë tinxherët shumë pak më tepër sesa mësim përmendësh të Kur’an-it, dhe rrjedhimisht, nuk përmirësojnë

prospektet e popullatës fshatare në nevojë.⁵²

Për fat të keq, brenda bashkësisë ndërkombëtare duket të ketë shumë pak interesim për atë se nëpër çfarë është duke kaluar Kosova fshatare në aspektin e mungesës së shërbimeve themelore. Rrjedhimisht, u është kushtuar gjithashtu vëmendje e vogël 98 shkollave fillore dhe të mesme të ndërtuara në Kosovë nga SJCRKC-ja.⁵³ Këto shkolla, që synojnë të përgatisin nxënësit premtues për shkollat më të mëdha të udhëhequra nga IEF-ja, po ndihmojnë në krijimin e gjeneratës së re të muslimanëve shqiptarë, ndjenja e të cilëve për përndjekje dhe neglizhencë bën që ata të shndërrohen në gjeneratë të të rinjve dhe të rejave lojaliteti i të cilëve nuk është Kosova, dhe që në vete përmbajnë jotolerancë të dhunshme ndaj të gjithë atyre që u kundërvihen trajnimeve të tyre.

Burimi i këtyre potencialit të urrejtjes është manifestuar para ca kohësh në letërën e një studenti të Institutit për Studime Islame në Prishtinë. Armend Podvorica, në një letër të hapur në *Koha Ditore*, ka dënuar qëndrimin e Rexhep Bojës për sa i përket aktiviteteve të grupeve vehabite në Kosovë. Reagimi i Podvoricës flet për ndjeshmërinë ndaj kundërshtimit të ndikimit në shtim të organizatave saudite, që është shpreh në radhë të parë për të pasqyruar strategjinë thelbësore për të nxitur ndjenjën e përkatësisë ndër ithtarët e vehabizmit. Çfarë është edhe më e rëndësishme, duke iu përgjigjur kritikës së Bojës, Podvorica zbulonte jotolerancën qenësore vehabite ndaj, në radhë të parë, trashëgimisë islamike në Kosovë. Në vijim të mbrojtjes së doktrinës vehabite si një “formë e pastër” e besimit, Podvorica shpjegon pse shqiptarët e Kosovës, edhe përkundër 500 viteve të traditës islame, ende nuk janë muslimanë të vërtetë.⁵⁴

Qartazi, sipas fjalëve të Podvoricës, kosovarët kurrë nuk kanë mësuar islamin e “vërtetë”. Në vend të kësaj, ata kanë trashëguar formën e “bastarduar” nga Turqia [sic] që “nuk ka të bëjë asgjë me fenë”. Podvorica, vazhdon duke sfiduar shqetësimet e shprehura të Rexhep Bojës lidhur me ekstremizmin, duke çmuar veprimet e “këtyre muslimanëve” (çuditërisht, duke nënkuptuar se Boja nuk është një ndër këta) të cilët drejtojnë shkollat dhe të cilët “janë të respektuar në Arabi”. Fakti se ata “pasojnë rrugën autentike”, supozohet se do të duhej të zbehë çfarëdo shqetësimi që mund të kenë lexuesit e *Kohës Ditore* për legjitimitetin e doktrinës vehabite, dhe që menjëherë të zbrapsë shqetësimet publike të Bojës. Duke qënë se muslimanët e zellshëm arabë të Podvoricës dallohen nga ajo që ky e cilëson si traditë e “bastarduar” islame, Podvorica vë në pah shenja të përfoljes së ngurtësisë doktrinare që dështon t’u bëjë vend interpretimeve të muslimanëve të tjerë, e lere më që të flitet me ta. Kjo ngurtësi Kosovës mund t’i sjellë tmerre.

Letra e Podvoricës vë në theks çarjet të cilat po ndodhin në rrugët e thella të Kosovës. Podvorica vrazhdë shënon kufirin ndërmjet pasuesve besnikë dhe të vërtetë nga ata të cilët nuk janë të tillë. Kjo metodë e diferencimit shumë shpejt do të mund të shndërrohet në formë më të shëmtuar shkëmbimesh. Në të vërtetë, tanimë ka pasur një numër të incidenteve në të cilat shqiptarët e stërvitur nga vehabitët kanë ndërprerë takimet publike duke sulmuar të gjithë që nuk u janë nënshtruar doktrinës së tyre. Ishte e qartë nga pjesëmarrja në një takim për kontrollin e lindjeve në Prizren më 2002, se ky

shpërthim ishte formë e kërcënimit, për të cilin bëj me dije se së shpejti do të shndërrohet në veprime të “ndëshkimit” publik të atyre që devijojnë nga “rruga e vërtetë”. Kjo metodë retorike e konfrontimit e përdorur nga Podvorica dhe kolegët e tij, është e mirënjohur në lagjet e varfëra të qyteteve arabe, ku organizatat vehabite janë përpjekur të marrin në duar të veta vendbanime nga grupet e tjera muslimane përmes akuzimit të oponentëve për tradhtim të islamit. Një gjë e tillë ka ndodhur në Pakistan, Tashkistan dhe në një numër të qyteteve fqinje arabe, dhe do të ndodhë edhe në Kosovë në rast se nuk bëhet asgjë për t’u dhënë këtyre fëmijëve fshatarë burime alternative të arsimit. Se kundërshtimi i Bojës ndaj doktrinës vehabite, interpretohet nga Podvorica dhe shqiptarët e tjerë nën magjinë e vehabitëve si kërcënim ndaj islamit dhe “tradhti”, është qenësore në të kuptuarit se si do të duket e ardhmja e Kosovës në rast se bashkësia ndërkombëtare vazhdon të injorojë Kosovën rurale.

Ka shqetësime se sfidimet e Bojës dhe të shqiptarëve të tjerë që i bëhen doktrinës vehabite nga ana e lojalistëve vehabitë interpretohet si gjest armiqësie, gjest ky që duhet konfrontuar në mënyrë agresive. Perceptimi i armiqësisë ndaj pasuesve vehabitë, që qartazi e nxit Podvoricën të reagojë me akuza për “traditat e bastarduara islame” të Bojës (dhe të Kosovës), lidhet me format të tjera të armiqësisë ndaj vehabizmit që emetohen për çdo mbrëmje në programet ndërkombëtare të lajmeve. Kjo është manifestuar në formë të garës institucionale ndërmjet bashkësisë së “themeluar” fetare vendore, BIK-ut, dhe “arabëve”. Deri më 27 prill, 2003, zyrtarët e BIK-ut sipërfaqësisht kanë sfiduar mësimet e vehabitëve në Kosovë.⁵⁵ Përderisa deklaratat nga kryeimami Sabri Bajgora mund të mëtojnë vendosje të rendit në bashkësinë islame, të stërkequr nga dekadat e shtypjes institucionale dhe lufta e viteve 1998-1999, janë edhe disa tensionime me peshë të cilat nuk mund të adresohen pa ndërhyrjen e UNMIK-ut dhe të BE-së. Ndjenja e mosmirëseardhjes në Evropë, ndjenja e të qenit i përndjekur për shkak të përkatësisë së “muslimanit të mirëfilltë” dhe vërtetë, fajësimi për ngjarjet në pjesë të tjera të globit është një temë e përbashkët për shqiptarët muslimanë të vetidentifikuar sot. Thjesht, përderisa bashkësitë fshatare në Kosovë janë bërë pak a shumë të varura nga SJCRKC-ja për nevojat e tyre themelore dhe gëzojnë pak apo fare aspak simpati nga bashkësia ndërkombëtare, ato janë gjithnjë e më të ndjeshme në qëndrimet e caktuara botërore të cilat në mënyrë inhereente janë armiqësore në Evropë dhe tërësisht në perëndim.

Qartazi nga kjo letër e Podvoricës, sjelljet e tilla nuk janë të drejtuara vetëm ndaj botës së jashtme. Gjatë rrugëtimit nëpër rajon në vitin e fundit, shihej qartë se si rezultat i qëndrimit për gati tri vite nën kujdesin saudit, të rinjtë e këtyre bashkësive kanë filluar të manifestojnë një intolerancë më të madhe ndaj larmisë së trashëguar kulturore dhe sektare të vendit. Kjo pasqyron të kuptuarit e ngurtë nga vehabitët për atë që e përbën bashkësinë islame dhe interpretimi i së kaluarës së Kosovës si diçka “jolegjitime” po zgjerohet ndër të rinjtë e bashkësive fshatare.

Thuhet se segregacioni i detyrueshëm i gjinive dhe përqëndrimi i arsimit të të rinjve meshkuj në pak më shumë sesa mësim përmendësh të Kur’an-it, ka tërhequr shumë pak apo aspak vëmendje të bashkësisë ndërkombëtare. Kur kemi parasysh se përmirësimi i

standardeve arsimore të Kosovës dhe nxitja e arsimit për vajza janë nën ombrellë të “kompetencave” të UNMIK-ut, është vërtetë tragjike që Kosova rurale të jetë në gjendje të tillë. Ndoshta edhe më e tmerrshme dhe e paimagjueshme pas ngjarjeve të 11 Shtatorit 2001, është fakti se indiferenca ndërkombëtare ka lejuar që ky monopolizim i jetës shpirtërore të Kosovës nga agjencitë saudite të rrenjosej edhe përbrenda vetë institucioneve të rajonit.

Vartësia e Kosovës rurale nga fondet fetare është siguruar përmes aleancave formale ndërmjet disa elementeve të Qeverisë së përkohshme, e në radhë të parë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe organizatave sauditë, të cilat në të kaluarën kanë ofruar barërat qenësore dhe pajisjet mjekësore për bashkësitë fshatare në fjalë. Ky boshnjak etnik dhe aktualisht ministër i suspenduar i shëndetësisë, Numan Baliq, me origjinë nga Novi Pazari i afërt (Sanxhak), për vite të tëra është njohur për animet e tij “fundamentaliste”, gjë për të cilën edhe ka braktisur Sanxhakun në fillim të viteve 1990. Duke u vendosur në Shqipëri, Baliq krijoi lidhje, ndër të tjera, me një shqiptar nga Shkupi, i cili në ndërkohë e ka ndërruar emrin në Muhamed Jusufi. Jusufi, “këshilltar politik” i Baliqit gjatë kohës kur ky ishte Ministër i Shëndetësisë, ka lidhje të gjata me Arabinë Saudite. Gjatë luftës së viteve 1998-1999, Jusufi ishte koordinator për agjencitë humanitare saudite në Shqipëri, dhe padyshim se me ndikimin edhe të këtyre agjencive, mori rolin e tij të ri afër Numanit. Historia e larmishme e Baliqit si udhëheqës politik në vendin e tij të ri, është thelbësore në kuptimin e lidhjeve të ndërlikuara ndërmjet vehabizmit saudit dhe nuancava të sektarizmit fetar që ka filluar të dalë në sipërfaqe në Kosovë. Baliq dhe Jusufi, dy jokosovarë, mund të shihen si figura qendrore në përpjekjet për të integruar prozelitizmin vehabi përbrenda rrymës primare politike dhe kulturore në Kosovë.⁵⁶

Një ndër pengesat më të mëdha në ballafaqimin me çështje të kësaj natyre, është politika e imponuar ndërkombëtarisht, e cila ka mëtuar të jetësojë disa ideale në shoqëritë vendore, me fleksibilitet të ulët apo edhe fare pa të për t'i përshtatur këto posa të bëhet e qartë se janë kundërproduktive për misionin e gjithëmbarshtëm. Përkundër provave për armiqësinë e Baliqit ndaj forcave “perëndimore” në Ballkan, siç del në shesh gjatë bisedimeve me një numër të madh të personelit të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) dhe personelit ndërkombëtar që mbikëqyr aktivitetet e përditshme të MSH-së, UNMIK-u duket të jetë i zënë në kurthën e politikës së “multikulturalizmit”, duke penguar në instancë të fundit përpjekjet e organeve qeverisëse, përfshirë qeverinë e Kosovës për të disiplinuar Baliqin për dështimet e tij si Ministër i Shëndetësisë, e të cilat shtrihen shumë më larg sesa lidhjet e tij me Arabinë Saudite. Në fund, ndërlihdhet përgjithësisht të injoruara të organizatave fetare saudite me qeverinë e Bosnjës dhe Ministrin Numan Baliq janë shkëputur pas një lufte të gjatë dhe të ndytë politike ndërmjet institucioneve të përkohshme të Kosovës, Baliqit dhe UNMIK-ut, me ç’rast ky i fundit shpeshherë ka ndërhyrë për të mbrojtur Baliqin nga disiplinimi për politikën e tij të dyshimta. Përderisa Baliq është shkarkuar nga posti i tij me vendim të Kryeministrit (ndërsa zyra e Steiner-it po e vonon shkarkimin formal nga frika prej pasojave politike), rrjeti i ndërlikuar i interesave të cilat janë lejuar të formësojnë sistemin shëndetësor të Kosovës akoma mund të paraqesin strehim të nevojshëm për ndikimin më të lartë sau-

dit në shumë pjesë të Kosovës, e të mos përmendin fare rastin e mbajtjes së Baliqit në pozitën e tij edhe përkundër listës së gjatë të veprimeve inkompetente dhe menaxhim-it të dobët.

Përpjekjet vendore për të adresuar forcën në rritje të SJCRKC-së

Në përpjekje për të zbrapsur atë që shumica e konsiderojnë të jetë përpjekje e SJCRKC-së për indoktrinim të popullatës rurale në Kosovë dhe për të marrë nën kontroll disa nga institucionet kryesore të Kosovës, vija të reja politika po formësohen në shoqërinë kosovare. Fatkeqësisht për stabilitetin afatgjatë të rajonit, këto ndarje politike pasqyrojnë më shumë se kurdo më parë, ndarjen fshat/ qytet të popullatës kosovare. Për pasojë, duket të ketë ndjenjë të theksuar të përndjekjes tek ata që kanë filluar të mbështeten në ndihmën e SJCRKC-së dhe tek një segment i vogël i popullsisë që ka pranuar doktrinën salafi. Prandaj, “islami politik”, mu ashtu siç është paraqitur në pjesët tjera të botës, ndonëse akoma në gjendje foshnjore në Kosovë, po transformohet ashtu që t’u përshtatet nevojave vendore. Bie fjala, në revistën e BIK-ut *Takvim*, hasen diskutime për përparësitë e krijimit të një partie islamike që do të adresonte problemet në fjalë të popullatës fshatare dhe problemet lidhur me neglizhencën administrative. Në të vërtetë, avokuesit e krijimit të një partie islamike zbulojnë ndjenjën në rritje për pushtet politik në shoqërinë kosovare, e tillë që po bëhet më intervencioniste kur është në pyetje ndikimi i zakoneve kulturore dhe arsimimi i shoqërisë sikundër edhe qëndrimin politik gjithnjë e më agresiv kundrejt botës së jashtme.

Ndikimi i fuqishëm që shkollat e financuara saudite kanë në perceptimet e bashkësive fshatare kundrejt botës së jashtme, jo vetëm që kanë krijuar tensionime brenda bashkësisë muslimane për sa i përket doktrinës, por kjo gjithashtu ka sfiduar harmoninë tradicionale ndërmjet shqiptarëve të krishterë dhe muslimanë. Një ndarje e dukshme është paraqitur, me ç’rast elemente radikale të bashkësisë shqiptare muslimane, sipas shenjave të dhëna nga sponsoruesit e tyre arabë, shkojnë aq larg sa të sfidojnë ndjenjat nacionaliste shqiptare të cilat shihen si të afërta me “trashëgiminë e krishterë”. Përveç shpalljes për “jobesimtarë” të heroit kombëtar shqiptar, Skenderbeut (që u rezistoi forcave otomane në shekullin e pesëmbëdhjetë), grupet saudite salefi haptazi kanë shprehur armiqësinë e tyre ndaj pranisë së amerikanëve dhe të ndikimeve të tjera “të korruptuara” perëndimore. Duke i lidhur shqiptarët katolikë me interesat perëndimore dhe varfërimin e vazhdueshëm të Kosovës fshatare, këto grupe kanë arritur sukses që është në rritje e sipër nëpër disa rajone dhe është vazhdimësi e strategjisë së miratuar nga Sarajeva gjatë erës së Titos.⁵⁷

Sërish, në momente të caktuara kjo ka prodhuar sfidime të zëshme nga shumë shqiptarë, si brenda institucioneve ekzistuese muslimane ashtu dhe brenda partive politike tërësisht sekulare, në veçanti për sa u përket sulmeve të grupeve salafi kundër

amerikanëve, ku këta të fundit nga shqiptarët konsiderohen si shpëtimtarë. Ky debat i hapur tregon se ka mjaft dyshim në motivet e grupeve bëmirëse fetare në përgjithësi ndërsa në veçanti janë vërejtur sulme ndaj “muhahedinëve arabë”. Duke qenë të lehtë për t’u identifikuar për shkak të mjekrrave të tyre të gjata dhe rregullave të thjeshta të veshjes, prania e këtyre individëve tejet fetarë rezultoi në supozim të menjëhershëm se ata janë të lidhur me ekstremistët sauditë. Kjo armiqësi ndaj “imperializmit arab” lehtë do të mund të përmbylej nga UNMIK-u dhe institucionet e tjera, në rast se procesi i ndërhyrjes do të siguronte që popullata fshatare të mos ndjejë nevojën për t’u rrekur shtegut të cilit iu rrekën afganët në vitet 1980. Në shembullin ndoshta më të mirë të asaj se çfarë ndjejnë shqiptarët ndaj rritjes në ndikim të organizatave saudite, agjencia e lajmeve Kosovapress, që konsiderohet të jetë armë mediale e partisë politike të dytë në Kosovë, nga fundi i dhjetorit, 1999, bën komentin në vijim.

“Për më shumë se një shekull vendet e civilizuara e ndajnë fenë nga shteti. [Megjithatë], ne tani po shohim përpjekje jo vetëm në Kosovë, por kudo që jetojnë shqiptarët, për të futur fenë në shkollat publike... Organizatat e huaja islamike të cilat fshihen prapa programeve të tilla të ndihmës, kanë zhvilluar lëndë plotësuese për fëmijë. Disa radio stacione tani gjatë natës ofrojnë transmetime në arabisht, gjuhë kjo të cilën askush nuk e kupton dhe që shumëkënd e bën për të pyetur vetën se a mos po jetojmë në vend arab? Është koha për xhamitë shqiptare që të ndahen nga lidhjet arabe, dhe për islamin që të zhvillohet i mbështetur në themel të kulturës dhe zakoneve shqiptare.”⁵⁸

Ky qëndrim më së miri thekson natyrën e shqetësimeve të një numri të madh kosovarësh urbanë për trashëgiminë e tyre islamike. Përkundër këtyre shqetësimeve dhe ndjeshmërisë në rritje ndaj “fundamentalizmit islamik” pas 11 Shtatorit 2001, ndikimet saudite vazhdojnë të shtojnë praninë e tyre në pjesët rurale, shpeshherë me miratim të bashkësisë ndërkombëtare e cila ka gjithnjë e më pak të holla për të ofruar. Çelësi, sërish, qëndron në ndihmën ekonomike të cilën mund ta ofrojnë organizatat saudite në fshatrat përgjithësisht të harruara, larg nga rrugët kryesore dhe shumë larg interesimit të organizatave ndërkombëtare. Meqë jetimoret dhe shkollat fillore saudite merren me mungesën serioze të arsimit dhe të shërbimeve sociale nëpër fshatra, audienca e “zënë” sigurohet për mesazhin thelbësor-propagandës që është në kundërshtim të drejtpërdrejt të vetë retorikës së “tolerancës” të nxitur nga UNMIK-u. Fëmijët që përfitojnë nga ndihma ekonomike, të cilën asnjë organizatë evropiane apo organizatë tjetër ndërkombëtare s’është e gatshme t’ua japë, shkojnë drejt vartësisë nga organizatat e tilla në të gjitha aspektet e jetës së tyre kulturore, sociale dhe ekonomike. Kjo vartësi i bën ata të lëndueshëm përballë strategjive afatgjata të organizatave salafi/vehabite me bazë në Arabinë Saudite dhe gjithashtu mund të rezultojë edhe në armiqësi në të ardhmen ndaj bashkëkombasve të tyre kosovarë, pjesës tjetër të Evropës dhe perëndimit në përgjithësi.

Shqipëria: Model për Kosovën?

Është interesante se në Shqipëri, menjëherë pas rënies së komunizmit dukej se gjërat janë duke shkuar në drejtimin që tani e ka Kosova. Ngjashëm me atë që po bëjnë në Kosovë, përfaqësues nga Irani dhe Arabia Saudite u ngutën më 1991 në Shqipërinë e varfëruar, me shpresë se do të indoktrinojnë atë që shihej si populli e ndjeshme. Të armatosur me pako ndihmash dhe shpeshherë me qëllime të padeklaruara, afatgjata për të drejtuar shqiptarët e rinj në lloj të veçantë të praktikave islame, shumë nga këto organizata u mirëpritën haptazi nga Kryetari Sali Berisha, duke shpresuar në nxitje ekonomike prej vendeve të pasura dhe prodhuese të naftës të gadishullit Arab dhe prej Iranit.

Në Shqipëri, rezultatet nga ky invazion virtuel i bëmiresive muslimane (dhe të krishtera) ishin të menjëhershme. Sipas një studimi të zhvilluar më 1994 nga dy universitete në Tiranë, tri të katërtat e studentëve të intervistuar u përgjigjen se besojnë në Zot, përderisa vetëm një e katërta e profesorëve të intervistuar pohonte të jenë besimtarë.⁵⁹ Kjo “rilindje” e besimit mund të ketë pasqyruar rilindjen e institucioneve fetare dhe garën për vijim të shkollave fetare të cilat pas vitit 1990 u hapën nga donatorët e huaj. Pasojë e këtij invazioni, nuk është patjetër ortodoksia rigjide. Madje, është interesante, se kryesisht si pasojë e perceptimit se shqiptarët janë në nevojë të reintegrimit fetar, rajoni ka qenë pikë e rivalitetit intensiv ndërmjet traditave konkurrenente “islamike” në vetë shkollat e ndërtuara për indoktrinim fetar.

Shembulli më i mirë i kësaj gjithashtu mund të gjendet në Shqipëri, me paraqitjen e grupit bëmires turk, i cili që nga fillimi i viteve 1990 ka monopolizuar arsimin e muslimanëve urbanë shqiptarë. Një disident i mëvetësishëm, Fethullah Gülen (1938-) me perandorinë e tij të madhe ekonomike, pedagogjike dhe shpirtërore, ka qenë mjaft i suksesshëm në eksportimin në Shqipëri të llojit të tij “turk” të islamit. Shkollat private “sekulare” të Gülenit, *dershanet*, janë paraqitur në Shqipëri që nga viti 1991, duke shërbyer si kundërpeshë efektive e organizatave më radikale arabe të cilat atëkohë filtroheshin në sistem.⁶⁰ Që nga vetë fillimi, programet zemërgjëra të ndihmave për familjet e varfëra, arsimim anglez të nivelit botëror dhe premtimet për arsim universitar në Turqi, kanë tërhequr me mijëra të rinj në këto shkolla. Përderisa mesazhi i këtyre shkollave është tejet fetar, ish studentët konfirmojnë se mesazhi i Gülenit është padyshim më “liberal” sesa ai i rivalëve të tij ortodoksë nga bota arabe. Kjo përkrahet edhe nga shkrimet dhe prononcimet e Gülenit, ku sugjerohet se literalizmi “arab” (më mirë i njohur si vehabizëm) nuk është islami i kohës moderne dhe qartazi gjykohet nga shkolla e tij. Ky sfidim i vlerave vehabite qartazi luan një rol të rëndësishëm në atë se si reintegrohet islami në jetën e shqiptarëve në Shqipëri, dhe pak a shumë i ka margjinalizuar shkollat e financuara nga arabët. Si rezultat i këtij dështimi për ndikim në Shqipëri, bëmiresitë arabe që nga viti 1999 kanë riorientuar të hollat dhe vëmendjen e tyre në Kosovë. Dallimi ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë mund të qëndrojë në faktin se përderisa organizatat e Gjirit Arab dominojnë në Kosovë, organizata e Gülenit në Kosovë ka ndërtuar vetëm një shkollë.

Prandaj, është e rëndësishme të theksohet se shqiptarët nuk janë të predestinuar për të marrë rrugën e “talibanëve”, ashtu siç duket se sot po ndodhë në disa bashkësi të shumta të Kosovës. Vërtetë, duket se muslimanët në Shqipëri me sukses kanë zbrapsur depërtimet vehabite në bashkësitë e tyre, duke pranuar haptazi një lloj më “liberal” të islamit të importuar nga Turqia, apo duke vijuar shumë shkolla të tjera sekulare dhe “të krishtera” të ndërtuara në vend. Në dallim nga Kosova rurale sot, prindërit në Shqipëri kanë një spektër të gjërë të mundësive për arsimin e fëmijëve të tyre dhe, çfarë është edhe më e rëndësishme, ata nuk ka pasur një burim të vetëm të ndihmës materiale të dëshiruara. Kjo larmi dëshmohet të jetë thelbësore. Të armatosur me alternativa doktrinare dhe sektare, muslimanët vendorë në rajonet shqipfolëse të Ballkanit, tregohen, kur u jepet rasti, efektivë në dëbimin e përpjekjeve indoktrinuese nga interesat e jashtme.

Përfundimet

Ky raport i shkurtër synon të vë në pah mënyrën e dyshimtë se si fuqitë perëndimore kanë caktuar prioritetet e tyre në rajon dhe se si agjencitë saudite kanë plotësuar këtë zbrastësirë. Çështja shtrohet se si politikatat perëndimore të “zgjidhjes së konflikteve” kanë lënë “bashkësitë” etno-fetare (përkatësisht muslimanët, të krishterët ortodoksë dhe katolikët) në mëshirë të organizatave ndërkombëtare të “mbështetura në fe”, të cilat nga ana e tyre në mënyrë të paturpshme shfrytëzojnë varfërinë dhe kushtet e fragmentuara sociale të shqiptarëve. Si rezultat i depërtimit të suksesshëm të këtyre organizatave në bashkësitë në fjalë, muslimanët në Kosovë gjithnjë e më shumë po bëhen të prekshëm ndaj armiqësive pasuese ndërmjet mu atyre qeverive të perëndimit të cilat neglizhuan adresimin e nevojave të tyre fillestare. Për ironi, përderisa qeveritë perëndimore dridhen para “rritjes së fundamentalizmit islamik”, politikatat e tyre diskriminuese ndaj popullatës rurale “muslimane” të Kosovës mund të tregohet të jenë drejtpërdrejt përgjegjëse për prodhimin e “talibanëve” vetanakë të Evropës, të cilët më vonë, me të vërtetë mund të tregohen armiqësorë ndaj “vlerave dhe interesave perëndimore.” Kjo porosi nuk duhet të shërbejë vetëm si ftesë për kthesë të menjëhershme të politikave në Kosovë për sa i përket financimit të zhvillimit fshatar, por gjithashtu edhe si vërejtje për bashkësinë ndërkombëtare të gatshme për të ndërhyrë në Irak.

Kur e them këtë, nënkuptohet se duhet kohë që të “thahet ngjyra në pikturë”. Vërtetë, gjatë historisë së islamit në Ballkan, shqiptarët kanë demonstruar një spektër të gjerë të animeve. Shqiptarët e Kosovës nuk janë të predestinuar për të qenë talibanë të ardhshëm. Siç kam përmendur në nëntorin e kaluar në një ligjëratë të mbajtur për këtë temë në Qendrën Woodrow Wilson, është ironike që ka qenë shqiptari Muhammad Ali, guvernatori i Egjiptit, ai i cili më 1840 shtypi kryengritjen vehabite në Arabi. Është po aq ironike që sot, shqiptarët janë të përfshirë nga po të njëjtat ndjenja të cilat i kanë ndaluar me forcat e tyre më 1840. Përderisa shumë në Kosovë, sikundër edhe në

Shqipëri, vazhdojnë të rezistojnë implikimet sektare të aktiviteteve fetare të shumë organizatave të ndryshme “bëmirëse”, të tjerët pranojnë se ardhja e këtyre organizatave propaguese krijon konflikte të brendshme, ngase njerëzit kështu udhëhiqen nga premtime për të holla, punë, arsim dhe identitet të ri. Përveq nëse i kushtohet vëmendje e menjëhershme ofrimit të alternativës për bashkësitë fshatare në Kosovë, spektakli i forcave të jashtme që manipulojnë me dallimet të brendshme, sikurse në Liban në vitet 1970 dhe 1980, dhe ndër refugjatët afganë në Pakistan, paraqet mundësi në vete. Do të ishte demonstrim tjetër tragjik i shkurtpamësisë perëndimore, në rast se dështimi nga ana e të njëjtit për të rivendosur jetën e qindra mijëra personave, do të rezultonte në dekada të konfliktit dhe të jostabilitetit. Koprracia ekonomike dhe shovenizmi kulturor që shkakton këtë neglizhencë mund të kthehen prapa dhe të ndjekin Evropën, duke hequr ashtu çdo iluzion se gjatë tre viteve të fundit në Ballkan gjërat janë bërë ashtu si duhet.

Sugjerime për zmbarsjen e trendeve të lartpërmendura:

1) Studime proaktive.

Sugjerohet që bashkësia ndërkombëtare të ndihmojë në krijimin e një departamenti të ri në Universitetin e Prishtinës, e i cili do të merrej me studimin e të kaluarës së larmishme etnike dhe kulturore të Kosovës. Udhëheqësia aktuale e Universitetit (anëtar i PDK-së) dhe departamentet e tij, sikundër edhe Ministri i Arsimit nga radhët e LDK-së (ekonomist), publikisht kanë shprehur përbuzje për “traditën”, folklorin etj. Ky shovinizëm provincial do të rezultoj në humbje të përhershme të kulturës e cila shkrinte në vete traditat gjuhësore, shpirtërore dhe materiale serbe, turke, rome, vllahe e të tjera. Një përpjekje e bashkërenditur për të përkujtuar të kaluarën e larmishme të Kosovës mund të zbutë logjikën e vrazhdë segregacioniste që sot ekziston në bashkësinë serbe dhe atë shqiptare karshi njëra-tjetrës. Kjo kërkon ndihmë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të Kosovës dhe zbulimin e asaj që është shlyer gjatë tetëdhjetë viteve të fundit. Në veçanti, u referohem këtu traditave muslimane sufiste dhe historisë katolike shqiptare, në masë të madhe të mbuluara nga heshtja e plotë akademike. Puna e studimit të larmisë së Kosovës, ngjashëm me planprogramet e reja të zhvilluara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për nënvizimin e larmisë raciale, etnike dhe fetare, do të bënte më shumë drejt synimit të “pajtimit” sesa forcimi i udhëheqësve politikë të cilët vijnë nga periudha tjetër, ajo e segregacionit. Megjithatë, një orvatje e tillë kërkon ambient pune të përshtatshëm për akademikë nga jashtë dhe për gjeneratën e re të Kosovës, që të jenë të lirë nga hegjemonia intelektuale e tanishme e Universitetit të Prishtinës.

2) Vënja e një regjimi të menjëhershëm rregullator për kontroll të organizatave “bëmirëse” fetare, duke përfshirë si ato të krishtera ashtu edhe organizatat muslimane.

3) Caktimin e një kontrolli të rreptë kufitar që do të parandalonte filtrimin e individëve

të padëshiruar në Kosovë. Është e qartë për autorin e këtij punimi se agjencitë saudite shfrytëzojnë fluturimet e *Turkish Airlines* nga Stambolli si një metode e përshtatshme për infiltrimin e individëve, të cilët përndryshe, nga zyrtarë kufitarë evropianë, do të vlerësoheshin si të rrezikshëm. Është dashur të tërheqë vëmendjen e personelit të sigurimit fakti se asnjë nga pjesëtarët vëhabitë të supozuar që punon në Kosovë nuk vjen nëpërmjet aerokompanive evropiane si *Swiss Airlines* apo *Austrian Airlines*. *Turkish Airlines* dhe shërbimet e saj të transferit në Prishtinë, paraqesin një shteg të përkryer për infiltrim, jo vetëm në Kosovë, por sipas të gjitha gjasave edhe në tërë rajonin. Përveç nëse bëhen kontrollime profesionale dhe të plota të të gjithë individëve që vijnë këtu e të cilët i përgjigjen përshkrimit, Kosova nuk do të jetë në gjendje që të merret me këtë problem afatgjatë.

4) Investime të menjëhershme në shkolla nëpër fshatra. Kjo përfshinë ndërtimin e më shumë shkollave, ristërvitje të arsimit dhe sigurim të bursave për një numër të madh studentësh për shumicën e shkollave. Kosova rurale, si edhe në të kaluarën, po izolohet tërësisht nga fakti se të hollat për zhvillim po kanalizohen në qytete. Se shkollat e financuara nga sauditët paraqesin të vetmin burim të “arsimit” duke ofruar të vetmen shpresë për shoqërinë fshatare, është arsye për të cilën personeli i UNMIK-ut do të duhej të turpërohet. Fakti se përkundër të gjitha miliardave të hudhura në Kosovë sistemi arsimor dhe Kosova rurale në përgjithësi është lënë pas dore, flet për menaxhment të dobët dhe një lloj arrogance, e cila do të kthehet për të ndjekur Evropën në të ardhmen e afërt. Nëse shqiptarëve të pjesëve rurale u jepet një zgjedhje e mundshme, kjo do të eliminonte joshjen nga shkollat saudite, ashtu siç ka ndodhur në Shqipëri.

5) Forcimi i organizatave vendore fetare. Dështimi për të ndihmuar në rizhvillim të traditave të vjetra do të ketë pasoja afatgjata për shoqërinë kosovare. Njerëz si Numan Baliqi nuk duhen lejuar të diktojnë përmbajtjen fetare të shoqërisë kosovare. UNMIK-u dhe bashkësia ndërkombëtare duhet që drejtpërdrejt të përfshihen në rivendosjen e rrugëve të vjetra të besimit. Kjo gjithashtu do të thotë që çështjet e islamit të mos i kalojnë Rexhep Bojës së BIK-ut, ngase kjo vetëm do të replikonte atë që Beogradi është përpjekur ta bëjë për më shumë se pesëdhjetë vjet. Larmia fetare e Kosovës dhe traditat burimore meritojnë kremtim, e jo çrrënjosje, dhe për të siguruar që kjo të vazhdojë bashkësia ndërkombëtare mund të investojë pak të holla.

6) Nxitja e ribotimit të shumë teksteve fetare, në veçanti të atyre të shkruara nga shqiptarët, mund të ndihmojë në zbutjen e pretendimeve vëhabite. Ky do të ishte manifestim i qëllimit të bashkësisë ndërkombëtare për të mbrojtur trashëgiminë islame të Kosovës. Nëse muslimanët shqiptarë nuk mund të lexojnë për alternativat e shumta të cilat ekzistojnë, ata kurrë nuk do të mund të binden për t'u shmangur nga doktrina vëhabite e cila sot po ngulitet në kokat e tyre.

7) Një përpjekje e fortë për të ripërtërirë traditat katolike në Kosovë. Ka një numër vendesh të lashta të cilat qëllimisht janë shkatërruar apo mbuluar me beton gjatë periudhës jugosllave. Nxitja e zhvillimit të interesimit për historinë e Kosovës, që nuk i shkon për shtati qëndrimit të rrezikshëm jugosllav kundër shqiptarëve katolikë, do të

ndihmonte në iluminimin e botës dhe forcimin e ndjenjës së bashkësisë ndër kosovarë. Kjo nuk është menduar për të ringjallur pretendimet nacionaliste, meqë një gjë e tillë mund të bëhet nga manifestimi i menduar dhe bujar i konsideratës së bashkësisë ndërkombëtare për gabimet e kaluara dhe përpjekjet për konfigurim të historisë së Kosovës nga ajo që me të vërtetë ishte, një shoqëri multietnike, diverse dhe heterogjene, dhe jo e tillë që i shkatërron të gjitha dëshmitë e trashëgimisë së shkrirë islame, katolike dhe ortodokse.

Shënime

¹ Cituar në Andras Riedlmayer, “Kosovo: The Destruction of Cultural Heritage,” në www.justiceforall.org, 1999.

² John Esposito gati njëzet vjet më parë nxiste lexuesit që të mos nënçmojnë aftësinë e shoqërive “tradicionale” si ajo e Arabisë Saudite për të prozelituar duke shfrytëzuar vetë mjetet bashkëkohore, të supozuara si mjete ekskluzive të shoqërive kapitaliste perëndimore. John L. Esposito, *Islam and Politics* (New York: Oxford University Press, 1984), 212.

³ Këto pelegrinazhe të përbashkëta janë vënë re gjatë shekujve në Kosovë dhe janë temë qendrore e hulumtimeve të antropologut holandez, aktualisht të vendosur në Londër, Ger Duijzings. Shih punimin e tij “Pilgrimage, Politics and Ethnicity: Joint Pilgrimages of Muslims and Christians and Conflicts over Ambiguous Sanctuaries in Yugoslavia and Albania,” në Mart Bax and Adrianus Koster (eds.), *Power and Prayer: Religious and Political Processes in the Past and Present*. (Amsterdam: VU University Press, 1993): 79-90.

⁴ Për një ndër prezentimet më të mira të trashëgimisë unike shqiptare muslimane, shih Robert Elsie, *History of Albanian Literature*, (Boulder: Social Science Monographs, 1995) vol. 1, 85-118, 195-208.

⁵ Për një shpjegim të sofistikuar të nuancave ndërmjet këtyre kategorive në Ballkan, shih, H.T. Norris, *Islam in the Balkans: Religion and Society between Europe and the Arab World* (London: Hurst, 1993), 82-137.

⁶ Në të vërtetë Sorabji ka vënë re se muslimanët e Bosnjës kanë miratuar retorikë më ksenofobe ndaj shqiptarëve (ata janë “përtacë, mosmirënjohës, të padisiplinuar dhe nuk janë muslimanë të vërtetë”) sesa ndaj serbëve. Shih Cornelia Sorabji, “Ethnic War in Bosnia?” *Radical Philosophy*, 63 (1993), 34.

⁷ Për politikën jugosllave të emigrimit të dhunshëm shih Isa Blumi, “Whatever Happened to the Albanians? Some Clues to a Twentieth-Century European Mystery” në *European Encounters, 1945-2000: Migrants, Migration and European Societies since 1945*. Eds. Ohliger, Schonwalder, Triadafilopoulos [London: Ashcroft, 2003], 231-268 dhe për mbylljen e xhamive në vitet 1950, shih Isa Blumi, “Albanians in Macedonia: Has the Rain Come?” *International Journal of Albanian Studies* [Fall, 1997]: 32-56.

⁸ Se si kanë arritur këto rende sufiste deri më 1998 në Kosovë të luajnë rol primar shpirtëror në jetën e përditshme të kosovarëve, shih Haki Kasumi, *Bashkësitë fetare në Kosovë 1945-1980* (Prishtinë: Instituti i Historisë i Kosovës, 1988), 65 dhe për historinë më të përgjithshme të vendosjes së tyre në Ballkan, shih Alexandre Popovic, *Les derviches balkaniques hier et aujourd'hui*. (Istanbul: ISIS, 1994). Nathalie Clayer ka bërë studimin më gjithëpërfshirës të sufizmit në Shqipëri dhe i cili është i dobishëm për të kuptuar më mirë sesi sufizmi është ushtruar gjatë shekujve: *Mystiques, État et société: Les Halvetis dans l'aire balkanique de la fin du XVIe siècle à nos jours* (Leiden: E.J. Brill, 1994).

⁹ Alexandre Popovic, *L'Islam balkanique: les musulmans du sud-est européen dans la période post-ottomane* (Berlin, 1986), 347-357.

¹⁰ Fejzulah Hadzibajric, “Tesavuf, tarikat i tekije na podrucju Starjesinstva IZ BiH danas,” *Glasnik vrhovnog islamskog starjesinstva u SFRJ*, XLII/3 (1979): 271-277, shih në

veçanti 273 dhe *Glasnik Vrhovnog Islamskog Starjesinstva* (1952), 199.

¹¹ Cornelia Sorabji, "Muslim Identity and Islamic Faith in Socialist Sarajevo," Disertacion i doktoranturës (Cambridge University, 1989), 163.

¹² *Glasnik Vrhovnog Islamskog Starjesinstva*, (1962), 185-186.

¹³ Ger Duijzings, *Religion and the Politics of Identity in Kosovo*. (New York: Columbia University Press, 2000).

¹⁴ Stephen Schwartz, *Kosovo: Background to a War* (London: Anthem Press, 2000), 87-101.

¹⁵ Një numër i banorëve të Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit tregojnë për projekte ndërtime gjatë viteve 1940 dhe 1950, kur bëheshin rrafsh me tokë monumente mesjetare katolike, përfshirë varrezat. Madje edhe deri më 1982 në Pejë në vendburimet arkeologjike janë gjetur objekte të cilat i takonin periudhës para dinastive të Nemanjiqëve, të adhurara nga nacionalistët serbë që nga vitet 1890.

¹⁶ Aktualisht, më i zëshmi nga këta potencues të pretendimeve neofashiste për Kosovën pa shqiptarë, është Dusan T. Batakovic, anëtar prominent i Universitetit të Beogradit. Shih, bie fjala, *Kosovo i Metohija. Istorija i Ideologija*, (Belgrade: Hriscanska Misao, 1998).

¹⁷ Kjo është bërë e qartë në Noel Malcolm, *Kosovo: A Short History* (New York: New York University Press, 1998), 41-57.

¹⁸ Letërkëmbim personal, Pejë, janar 2003. Është interesante se, ndoshta si rezultat i kësaj, thënia e muslimanëve të vjetër kosovarë që pasqyron armiqësinë e përgjithshme ndaj boshnjakëve. "Shtrydhe një boshnjak dhe dalin shtatë shki."

¹⁹ Shumica nominale e Pejës është e njohur për mbajtjen jashtë jetës së tyre të katolikëve. Ndër bashkësinë muslimane të Pejës, besohet se mëkatën më të madh që mund ta bëjë fëmija është, bie fjala, të martohet me katolik, veprim ky që konsiderohet sikurse përzierje përgjithmonë e gjakut të familjes. Letërkëmbim personal, Pejë, janar 2003.

²⁰ Letërkëmbim personal, Pejë, janar 2003.

²¹ Siç është konfirmuar nga bisedat me pjesëtarë të moshuar të bashkësive katolike nga Gjakova dhe Prizreni që tani jetojnë në New York, shtator 1997 dhe muslimanë që jetojnë në Klinë dhe Prizren, gusht 1999.

²² Shih Isa Blumi, "Contesting the Edges of the Ottoman Empire: Rethinking Ethnic and Sectarian Boundaries in the Malësore, 1878-1912." në *International Journal of Middle East Studies*, 35/2 (May 2003): 237-256.

²³ Për të dhënat e regjistrimit civil shih "Jugosllavija 1918-1988, Statisticki godisnjak" (1989).

²⁴ Migrimet më të mëdha të katolikëve nga Kosova ndodhën menjëherë pas Luftës së Parë Botërore, Luftës së Dytë Botërore dhe gjatë periudhës së Rankoviqit. Ndërsa, edhe gjatë viteve 1980, një numër shpërpjestimisht i madh i emigrantëve kosovarë në Evropën Perëndimore dhe në Amerikën Veriore ishin katolikë. Për historinë e Kishës Katolike në pjesët e banuara me shqiptarë të Kosovës dhe Maqedonisë, shih Gjini Gasper, *The Shkup-Prizren Diocese through the Centuries* (Prizren: Drita, 2000).

²⁵ Ky proces është vënë re nga Alexandre Popovic, "The contemporary situation of the Muslim mystic orders in Yugoslavia," në Ernest Gellner (ed.), *Islamic Dilemmas: Reformers, Nationalists and Industrialization: The Southern Shore of the Mediterranean*. (Berlin: Mouton, 1985), 247.

²⁶ Kjo është zbuluar në një raport të gazetarit serb që ka hulumtuar një epizodë të përgjakshme të represionit në Beograd. L. Bulatovic, *Prizrenski proces* (Novi Sad, 1988), 91-93.

²⁷ *Buletin HU* 1984, 12 dhe Sladjana Djuri?, *Osveta i Kazna. Sociolosko istrazivanje krvne osvete na Kosovu i Metohiji* (Nish: Prosveta, 1998), 107.

²⁸ *Buletin HU* (1978) vol. 2, 6.

²⁹ Shih Sharifi Ahmeti's article in *Glasnik Vrhovnog Islamskog Starjesinstva*, 1979, 283-287.

³⁰ Ndër të tjera, shih Dusan Batakovi?, *The Kosovo Chronicles* (Belgrade: Plato, 1992).

³¹ *Glasnik Vrhovnog Islamskog Starjesinstva*, (1975), 296.

³² I tërë takimi dhe përmbajtja e tij janë përshkruar në botimin special të *Glasnik Vrhovnog Islamskog Starjesinstva*, no. 3 (1979).

³³ Disa autorë dallohen për përshkrimet e tyre të fuqishme dhe sensacionale të “egërsisë” dhe “primitivizmit” të shqiptarëve. Racizmi i hapur i Dejan Luçi-it kishte lexues të shumtë në Serbi dhe libri i tij *Tajne albanske mafije* (Fshehtësitë e Mafias Shqiptare) botuar më 1988, lavdëronte njësoj punën derogatore të Bulatoviçit dhe të tjerëve në periudhën e Millosheviçit.

³⁴ Djuri? ka vënë re këtë më 1998, *Osveta i Kazna*, 109. See also *Buletin HU* 1978 (4), 12.

³⁵ Shih Amnesty International, *A Human Rights Crisis in Kosovo Province. Document Series B: Tragic events continue, No. 3 Orabovac, July-August 1998. EUR 70/58/98*, pages 4-6.

³⁶ Konsulto faqen zyrtare saudite në internet për aktivitetet e “bëmirësive” të ndryshme saudite në Kosovë: www.saudinf.com.

³⁷ Manifestimi i fundit i kësaj ndodhi si reagim ndaj një hulumtimi tim të paradokohshëm në këtë temë, dhe që më pas është cituar shtrembër në raport të shërbimit të lajmeve UPI. Përsëritja e shqetësimeve nga ana e Rexhep Bojës lidhur me ndikimin e Vahebive në Kosovë, është shoqëruar nga një citat marrë prej një zyrtari të UNMIK-ut që serish demonstroi injorancën e bashkësisë ndërkombëtare për gjendjen në Kosovë. Shih “Edhe një rrezik për Kosovën: Wahabitë,” *Koha Ditore* (4 January 2003).

³⁸ Shih M.Sh. Alusi, *Tarikh Najd*, ed. M. B. Athari, (Cairo AH 1343/AD 1924), 50ff dhe Al Jabarti, *Min Akhbbar al-Hijaz wa Najd fi Tarikh al-Jabarti*, ed. M.A. Ghalib, (n.p. 1975), 97.

³⁹ H. Khalaf al-Shaykh Khaz ‘al, *Hayat al-Shaykh Muhammad b. ‘Abd al-Wahhab* (Beirut, 1968), 119ff.

⁴⁰ Ibn Bishr, *‘Uman al-Majd fi Tarikh Najd*, 2 vols, (Riyadh: AH 1385, 1388/AD 1965, 1968) vol.1, 18 and M.A. Khan, “A Diplomat’s Report on Wahhabism in Arabia,” *Islamic Studies*, 1 (1968): 32-48.

⁴¹ M. Kurd ‘Ali, *Al-Qadim wa ‘l-Hadith*. (Cairo, 1925), 157.

⁴² M.R. Rida, *Al-Wahhabiyya wa ‘l-Hijaz*. (Cairo: AH 1344/AD 1925), 34.

⁴³ W. Sharara, *Al-Ahl wa ‘l-Ghanima: Muqanwimat al-Siyasa fi ‘l-Mamlaka al-‘Arabiyya al-Su‘udiyya*. (Beirut, 1981), 124.

⁴⁴ *Majmu‘at al-Tawhid*, (Saudi Arabia, n.d.), 52 and passim.

⁴⁵ *Majmu‘at al-Tawhid*, 284.

⁴⁶ *Majmu‘at al-Tawhid*, 121-122 and cf. 251ff.

⁴⁷ Sharara, *Al-Abl wa'l-Ghanima*, 91.

⁴⁸ Sulayman b. 'Abdillāh b. Muhammad b. 'Abd al-Wahhab, *Taysir al-'Aẓīz al-Hamid fil Sharh Kitāb al-Tawhid* (Damascus, n.d.) është koment i detajuar për këto doktrina.

⁴⁹ Sharara, *Al-Abl wa'l-Ghanima*, 101.

⁵⁰ Isa Blumi, "Kosova: From the Brink—and Back Again" *Current History* (November, 2001): 15-20.

⁵¹ Konsulto faqen zyrtare saudite në internet për aktivitetet e "bëmirësive" të ndryshme saudite në Kosovë: www.saudinf.com.

⁵² Biseda personale të zhvilluara nëpër rajonin e Drenicës në periudhën 2000-2003.

⁵³ Shih Isa Blumi, "Indoctrinating Albanians: The Dynamics of Islamic Aid in the Balkans" *ISIM Newsletter* [March 2003]: 9.

⁵⁴ Armend Podvorica, "Besimi i denjë nuk është ekstremizëm," *Koha Ditore* (7 janar, 2003), 11.

⁵⁵ Arbana Xharra, "Nisma e Bashkësisë Islame nxit reagime të fuqishme në shkolla," *Koha Ditore*, 27 prill, 2003, 1 dhe 4.

⁵⁶ Për më shumë detaje, konsulto Isa Blumi, "The Islamist Challenge in Kosova." *Current History* [March 2003]: 124-128.

⁵⁷ Kjo mund të vërehet në përpjekjen e BIK-ut për të vendosur edukimin "fetar" në shkolla, një kundërofenzivë të drejtuar ndaj depërtimit të Vahebive, por ndoshta duke dëmtuar çdo shpresë për mbajtjen bashkë të bashkësisë sekulare dhe shumëfetare. Shih Arbana Xharra, "Nisma e Bashkësisë Islame nxit reagime të fuqishme në shkolla," *Koha Ditore*, 27 prill, 2003, 1 dhe 4.

⁵⁸ Konsulto arkivin e www.kosovapress.com, 29 dhjetor, 1999.

⁵⁹ Adem Tomo, "Attitudes towards religion and the religious motivations of students and intellectuals." Appearing in the first volume of "Social-pedagogical reflections," botuar nga një grup autorësh në Tetovë, Maqedoni, (1996), 15-22.

⁶⁰ Për dy botime të paradokohshme në këtë temë shih: Bekim Agai, "Fethullah Gülen and his Movement's Islamic Ethic of Education," *Critique: Critical Middle Eastern Studies* 11 (1) (Spring 2002): 27-47 dhe Bayram Balci, "Fethullah Gülen'in neo-nurcu okulları,"

design & prepress: PIKA (www.pikastudio.net)

Katalogimi në publikim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

32:297 (496.51) (06)

ISLAMI politik ndër shqiptarët : A po vijnë talibanët në Ballkan?
/ [Përpiluar nga Isa Blumi ; Përkthyer nga Ilir Dugo- lli]. - [Ribotim]. -
Prishtinë : KIPRED, 2005 (Prishtinë : „ADD”) . - VI, 30 fq.; 24 cm. -
(Seria e kërkimeve politike : Studimi # 2)

Shënime : fq.26-29

1. BLUMI, Isa 2. DUGOLLI, Ilir

ISBN 9951-14-014-9

Për KIPRED-in

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave ka për qëllim të përkrahë vlerat demokratike në Kosovë përmes trajnimeve dhe analizave të pavarura të politikave publike.

Trajnimet kryesisht fokusohen në zhvillimin e partive politike përmes Internet Akademisë për Demokraci, e zhvilluar në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare Olof Palme nga Suedia.

Kërkimet fokusohen në botimin e analizave të pavarura në fusha si qeverisja e mirë, administrata, zhvillimi i partive politike, bashkëpunimi rajonal, politika ekonomike dhe qeverisja lokale.

KIPRED-i financohet nga fondacioni suedez “Olof Palme International Center” dhe nga fondacioni amerikan “Rockefeller Brother’s Fund”.

KIPRED
Kodra e Diellit, Rr. III, Ll. 39
Prishtinë, Kosovë (UNMIK)
Tel/Fax: +381 (0) 38 555 887
Info: kipred@hotmail.com
www.kipredinstitute.org

Përkrahur nga:



Rockefeller
Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World